

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL (AZHBR)

Objektivat strategjike:


AZHBR është person juridik i Qeverisë Shqiptare nën varësinë e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural që ka për qëllim dhënien e mbështetjes financiare si Agjenci Pagesash për financimin e sektorit bujqësor, agropërpunimit dhe zhvillimit rural nëpërmjet pagesave direkte dhe granteve.

Trajtimin e sfidave me të cilat përballen sektori i bujqësisë dhe agropërpunimit, si dhe zhvillimi i zonave rurale në një mënyrë të qëndrueshme ekonomike, mjedisore dhe sociale duke zbatuar politikat e hartuara për këtë qëllim


Vëmendje të veçantë i kushtohet përgatitjes së sektorëve, instrumenteve të politikave dhe përshtatjes institucionale për anëtarësimin në BE, për të arritur një përmirësim të qëndrueshëm të konkurrencës së Shqipërisë.

Arritjet Financiare:


- Fond i angazhuar në Vitin 2022 është 2.3 miliard lekë (116 kontrata të nënshkruara, vlera e dhënë është vlera e Grantit).



- Disbursuar në Periudhen Janar - Dhjetor 2022, 200 pagesa nga IPARD II në vlerë: 2,32 miliard lekë.



Grafik: Investime të përfunduara gjatë 2022 nën IPARD II, për masë



Grafik: Disbursime EUR të investimeve të përfunduara nën IPARD II 2014-2020, për Qark, thirrja e I




Grafik: Disbursime EUR të investimeve të përfunduara nën IPARD II 2014-2020 për Qark, thirrja e II



Grafik: Disbursime EUR të investimeve të përfunduara nën IPARD II 2014-2020 për Qark, thirrja e III


Thirrja 4: Buxhet i Aplikuar vs Buxhetit të kontraktuar për Qark



Në total ka patur 132 Aplikime nën thirrjen e 4, masa 7 me një vlerë EU(75%) të kërkuar prej 18.14 mln Eur, prej të cilave janë kontraktuar 29 projekte në agroturizëm me vlerë granti EU prej 5.1 mln euro.

- Disbursuar 99 % e buxhetit të alokuar prej 5.1 miliard lekë për 48,656 aplikime të Skemave Kombëtare



BUXHETI NE MLN LEKË



Grafik: *Buxheti i Skemave Kombëtare ndër vite*

Buxheti i alokuar në vitin 2022, ka qenë buxheti më i lartë i alokuar ndër vite, 5.1 Mld Lekë (sa buxheti i 5 viteve së bashku)

Implementimi i Skemave Kombëtare sipas masave të mbështetura:



Arritjet Operacionale

- U mbyll thirrja e katërt IPARD II me administrimin 132 aplikimeve në masen 7 me kërkesë për grant 24 mln Euro;
- U mbyllën me sukses thirrjet për Skemat Kombëtare 2022 me një numër prej 12,048 aplikime për masat direkte, 49,654 aplikime për skemën e naftës dhe 7464 aplikime skema e grurit.
- Në Mars të vitit 2022 është miratuar edhe Programi IPARD III, me një fond total prej 146 Mln Euro. (54 %) më i lartë se buxheti i IPARD-II

Të ecim përpara:

Fokusi ynë: mbështetje financiare për zhvillimin e fermave/fermerëve për të arritur standartet e Bashkimit European.

I. BAZA LIGJORE E FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (A.ZH.B.R.), është krijuar në zbatim të Ligjit me Nr. 9817, datë 22.10.2007 “Për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, me Vendim të Këshillit të Ministrave me Nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (A.ZH.B.R.), si Agjenci e Pagesave”, i ndryshuar me VKM Nr. 877, datë 14.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 719, datë 31.10.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural (A.ZH.B.R.), si Agjenci e Pagesave”, me detyra kryesore administrimin e:

- a) Fondeve të buxhetit të shtetit;
 - b) Fondeve kundërparti, të ish-projektit 2KR;
 - c) Fondeve të Bashkimit Evropian;
 - d) Fondeve të siguruara nga shtete apo organizma të tjerë me qëllim zhvillimin bujqësor e rural në Shqipëri.
- Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural kryen funksionet e saj aktuale mbi bazën e organigramës organizative të miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 81 datë 10.05.2022, “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”.


II. ORGANIGRAMA E AZHBR-SË

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, deri më 10.05.2022, ka kryer funksionet e saj me 203 punonjës, mbi bazën e organigramës organizative të miratuar me Urdhërin e Kryeministrit Nr. 143, datë 03.11.2022 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”. Sipas kësaj strukture AZHBR-ja ka qenë e organizuar mbi bazën e 6 drejtorive me 17 sektorë dhe 3 sektorë të varur direkt nga Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR: Sektori i Auditimit të Brendshëm, Sektori i Riskut, Parandalimit të Mashtrimit, Analizës dhe Raportimit, Sektori i Promocionit dhe Komunikimi.

Me Urdhërin nr. 81, datë 10.05.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”. Sipas kësaj strukture AZHBR-ja është e organizuar mbi bazën e 9 drejtorive me 22 sektorë dhe 2 sektorë të varur direkt nga Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR: Sektori i Auditimit të Brendshëm, Sektori i Parregullsisve dhe Parandalimit të Mashtrimit. Struktura e miratuar plotëson të gjitha kriteret e parashtruara në Marrëveshjen Sektoriale si dhe të rekomanduara nga Audituesit dhe është përshtatur për zbatimin e masave kombëtare dhe të IPARD-it. Mbi bazën e strukturës së re dhe në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike është në proces ristrukturimi i AZHBR-së. Organigrama si me poshtë:

Figura nr. 1: Organigrama e AZHBR

ORGANIGRAMA E AGJENCISË PËR ZHVILLIM BUEJQËSOR DHE RURAL



259

III. DREJTORIA E PËRZGJEDHJES DHE APROVIMIT TË PROJEKTEVE (DPAP)

DPAP është përgjegjëse për pranimin dhe regjistrimin e aplikimeve, kontrollin administrativ të tyre, vlerësimin, përzgjedhjen dhe renditjen e aplikimeve të pranuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, me udhëzimet dhe procedurat përkatëse të MBZHR dhe MFE.

DPAP është përgjegjëse për kontraktimin e përfituesve dhe për të krijuar një linjë të rregullt të komunikimit me të gjitha drejtoritë e tjera brenda AZHBR-së.

Qëllimi i DPAP është realizimi i lidhjes së të gjitha kontratave me aplikantët e përzgjedhur nga thirrja e parë dhe të dytë të programit IPARD II dhe monitorimi i kontratave tashmë të lidhura në mënyrë që të ndiqen aplikantët deri në kërkesën për pagesë duke mbështetur procesin e përthithjes së fondeve IPARD. Gjithsej DPAP ka administruar deri më tani 4 thirrje nga Programi IPARD II.

A. Sektori i Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD

DPAP së bashku me DJSHM brenda AZHBR-së dhe AM janë përgjegjës për përgatitjen dhe planifikimin e thirrjeve për aplikim dhe për marrjen dhe regjistrimin e aplikimeve për projektet, kontrollin administrativ të aplikimeve të marra, kontrollin e plotësisë dhe përshtatshmërisë së aplikimit, renditjen e aplikimeve të pranueshme dhe kontraktimin e aplikimeve të miratuara.

Objektivat

Objektivat dhe prioritetet e masave të Programit IPARD II të përzgjedhura janë në përputhje me objektivat e Dokumentit Strategjik Kombëtar (DSK) dhe kontribuojnë për:

- Mbështetjen e investimeve në sektorin agro-ushqimor me qëllim përmirësimin e konkurrencës, pajtueshmërinë me standardet e BE-së dhe ruajtjen e natyrës dhe mjedisit;
- Mbështetjen e investimeve në zonat rurale me qëllim diversifikimin e ekonomisë rurale dhe krijimin e biznesit, duke çuar në përmirësimin e mundësive të punësimit dhe përfshirjes sociale.

Takime informuese u organizuan në Janar 2022 në të gjitha qarqet për realizimin e Thirrjes së Katert për aplikime, programi IPARD-II me pjesëmarrjen e aplikantëve potencialë duke përfshirë fermerë, persona fizikë osë juridikë, shoqëri të bashkëpunimit bujqësor (SHBB), trupat teknike, të interesuar të tjerë që kërkojnë të përfitojnë nga programi IPARD, konsulentë privatë, banka, dhe aktorë të tjerë të interesuar.

Thirrja e katert për aplikime u hap për Masën 7: “Diversifikimi i fermave dhe zhvillimi i biznesit” me fokus të veçantë në sektorët e Turizmi rural dhe i Natyrës dhe Punimet e artizanatit dhe industria e manufaktures.

Objektivi e përgjithshëm i masës është nxitja e punësimit përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe mbajtjes së atyre ekzistuesë përmes zhvillimit të veprimtarive të biznesit, duke rritur në këtë mënyrë nivelin e veprimtarive ekonomike të zonave rurale, duke rritur drejtë për së drejti të ardhurat e familjeve fermere dhe shmangur braktisjen e zonave rurale, duke kontribuar në një balancë më të mirë territoriale si në aspektin ekonomik ashtu edhe në atë social.

Buxheti në dispozicion i kësaj Thirrje, u rrit nga 5.2 milion Euro në 9.8 milion Euro sipas vendimit të Komisionit DEC C (2022) 5478, nga të cilat 75% osë 7.4 Milion Euro kontribut i BE dhe 25% osë 2.4 Milion Euro kontribut I buxhetit të shtetit.

Realizimi

Gjatë muajve Janar-Dhjetor të vitit 2022, Sektori i Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD ka zbatuar: U pranuan 132 aplikimeve nën Thirrjen 4 nën masën 7 janë pranuar nga të cilat 125 aplikime nën sektorin e Natyres dhe Turizmit Rural dhe shtatë nën sektorin e Punimeve të artizanatit dhe industrisë së manifaktures.

Tabela nr 1. Numri i aplikimeve të pranuar nën Thirrjen e katert Programi IPARD II dhe vlera totale e investimit të kërkuar.

Sektori	Numri i Aplikimeve	Vlera totale e investimit të kërkuar LEK	Vlera totale e shpenzimit publik të kërkuar LEK
M7 – Punimet e artizanatit dhe industria e manifaktures	7	58,368,606.75	45,053,696.20
M7 – Natyra dhe turizmi rural	125	5,301,395,933.51	2,895,452,571.66
Totali	132	5,359,764,540.26	2,940,506,267.86

Tabela nr 2. Statusi i aplikimeve për të gjitha thirrje t për periudhën raportuese.

Statusi	Numri I aplikimeve
Numri i skualifikimeve	79
Numri i Kontratave	29
Numri i terheqjeve	3
Në shqyrtim	21
Totali	132

Nga 21 aplikime në shqyrtim, 9 janë në EVC.

Tabela nr 3. Numri i aplikimeve sipas rajoneve.

Rajoni	Numri i Aplikimeve
Tiranë	24
Shkodër	17
Korçë	16
Vlorë	14
Dibër	11
Elbasan	9
Berat	8
Durrës	8
Gjirokastër	8
Kukës	7
Lezhë	7
Fier	3

B. Sektori i Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve IPARD Asistenca Teknike

Objektivat

1. Të përmbushë detyrat konform programit IPARD dhe manualit.
2. Të përditësojë procedurat e zbatimit për menaxhimin dhe zbatimin e masës 9 Asistencës Teknike sipas Programit IPARD 2014-2020 dhe rregullores PRAG, me qëllim zbatimin ligjor, efektiv dhe efikas të fondeve IPARD.

Realizimi

Gjatë muajve Janar-Dhjetor të vitit 2022, sipas Planit të Veprimit të aprovuar nga Komiteti Monitorues dhe në përputhje me rregulloren PRAG si dhe manualin e procedurës Sektori i Asistencës Teknike ka zbatuar 2 kontrata sipas të dhënave të mëposhtme:

Tabela nr 4. Numri i kontratave te AT për vitin 2022

Nr	Përfituesi	Aplikimi	Vlera në lek kontributi EU	Vlera në lek kontributi Kombëtar
1	Autoriteti Menaxhues	Mbledhja e 8-të e Komitetit të Monitorimit të Programit IPARD 2014-2020.	254,871.65	44,977.35
2	Autoriteti Menaxhues	Mbledhja e 9-të e Komitetit të Monitorimit të Programit IPARD 2014-2020	247,613.50	43,696.50
			502,485.15	88,673.85

Referuar parashikimeve dhe Planit të Veprimit (APTA) rezulton se deri më tani është kontraktuar 89.33% e fondit në dispozicion për këtë masë.

C. Sektori i Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve Kombetare

Në zbatim të Udhëzimit Nr. 1, Datë 11.2.2022 “Për Kriteret, Procedurat dhe Mënyrën e Administrimit të Fondit të Programit për Bujqësinë Dhe Zhvillimin Rural” aplikimet jane hapur me date 25.02.2022 dhe përfunduan me 30.03.2022.

Këtë vit për herë të parë, në mbështetje të Udhëzimit Nr. 14 datë 01.08.2022 është shtuar edhe masa 7.1 ”mbështetje për kultivimin e grurit për sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 ha në vlerën 30,000 lekë për ha”.

Buxheti për vitin 2022 ishte 5.1 Mld lekë.

Masat që do të mbështeten

- Masa 1. Mbështetje për fara-fidane dhe input-e të tjera në sera;
- Masa 2. Ndertimi i serrave diellore përfshire vaditjen me pika;
- Masa 3. Mbështetje për kultivimin e bimëve mjekësore e aromatike;
- Masa 4. Fermat organike të certifikuara;
- Masa 5. Implementimi dhe certifikimi Global GAP;
- Masa 6. Për tufën bazë të matrikulluar;
- Masa 7. Mbarështim i bletarisë;
- Masa 7.1 Mbeshtetje per mbjellje siperfaqe gruri;
- Masa 8. Blerja e anijeve të peshkimit;
- Masa 9. Rinovimi i anijeve të peshkimit;
- Masa 10. Ndertimi i tregjeve të produkteve bujqesore dhe blegtorale;
- Masa 11. Trajnimi në bujqësi dhe ngritja e Qendrës së Ekselencës dhe inovacionit te sistemeve prodhuese në UBT në bashkëpunim me një nga Universitetet Europiane;
- Masa 12. Mbështetje për automatizimin dhe dixhitalizimin e proceseve të punës në fermë;
- Masa 13. Mbështetje me naftë për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi.

Tabela nr 5: Shperndarja e aplikimeve te aprovuara sipas masave dhe qarqeve per masat direkte

Qarku	Aplikime gjithsej nga portali	Alikime te Perserituara	Aplikime gjithsej aktive	Intpute	Kultivimi BAM	Femra Organike	Global Gap	Tufe baze	Bletari
Berat	986	138	848	190	5	12	3	457	181
Diber	550	46	504	3	1	6	3	290	201
Durres	317	12	305	12	2	46	3	168	74
Elbasan	966	86	880	54	90	27	5	381	323
Fier	1906	186	1720	446	28	62	25	881	278
Gjirokater	1490	217	1273	2	2	13	5	1027	224
Korce	2119	267	1852	15	29	14	3	1177	614
Kukes	639	80	559	1	1	2	1	350	204
Lezhe	288	22	266	4	2	13	0	167	80
Shkoder	1598	168	1430	17	740	39	2	412	220
Tirane	632	51	581	60	1	6	4	336	174
Vlore	1994	241	1753	9	7	6	2	1369	360
Totali	13485	1514	11971	813	908	246	56	7015	2933

Tabela nr 6: Shperndarja e aplikimeve te aprovuara sipas qarqeve per masen e Grurit

QARKU	Aplikime Mbjellje siperfaqe me grure					
	Aplikime te kualifikuara sipas listave			Aplikime te aprovuara (per kontroll ne terren) brenda vijes se financimit		
	Nr. Aplikime	Sip. HA	Vlere aplikimi	Nr. Aplikime	Sip. HA	Vlere aplikimi
Berat	299	625	18,753,120,00	171	370	11,118,840,00
Diber	215	593	17,777,385,00	128	423	12,710,643,00
Durres	353	1722	51,662,415,00	220	1065	31,970,022,00
Elbasan	540	1075	32,229,900,00	372	816	24,486,000,00
Fier	2599	7990	239,700,000,00	1449	4776	143,306,991,00
Gjirokaster	180	1399	41,966,010,00	132	780	23,420,163,00
Korce	1559	5346	160,372,857,00	746	3006	90,205,227,00
Kukes	48	157	4,704,480,00	19	85	2,570,172,00
Lezhe	274	972	29,161,722,00	204	628	18,842,046,00
Shkoder	502	1820	54,606,420,00	335	1186	35,587,062,00
Tirane	482	2409	72,268,530,00	370	2125	63,756,138,00
Vlore	413	3946	115,372,080,00	236	1947	58,420,578,00
Totali	7464	27327	838,574,919,00	4382	17207	516,393,882,00

Tabela nr 7: Shperndarja e aplikimeve te aprovuara sipas qarqeve per masen e Naftes

QARKU	Nr aplikimesh, per masen e Naftes	Litra te Aplikuar, per masen e Naftes	Nr. Aplikimesh disbursuar karta e naftes	Siper ne HA e mbeshtetur faza e pare	Litra nafte
Berat	6478	1,164,442,00	4616	7994	837,018,01
Diber	1895	354,276,00	1332	2996	243,159,00
Durres	1278	411,518,00	763	3619	237,454,00
Elbasan	5412	1,061,768,00	3516	7702	686,487,00
Fier	14658	4,162,845,00	10315	26763	2,829,865,08
Gjirokaster	1223	266,718,00	794	2225	139,595,15
Korce	11372	2,073,299,00	8245	19939	1,483,426,84
Kukes	112	19,144,00	89	213	14,885,00
Lezhe	673	204,017,00	428	1427	120,284,00
Shkoder	2203	785,795,00	1735	8133	602,365,91
Tirane	1990	740,019,00	1494	8155	546,124,00
Vlore	1945	717,574,00	1403	9760	506,239,00
Totali	49239	11,961,415,00	34730	98931	8,246,902,99

IV. DREJTORIA E AUTORIZIMIT TË PAGESAVE (DAP)

Për realizimin e objektivave të mësipërme DAP ka ndjekur me përpikmëri procedurat administrative të autorizimit të pagesës si dhe ka kryer procesin e autorizimit të pagesave duke realizuar kontrollin administrativ të kërkesave për pagesë si dhe përllogaritjen e vlerave për t'u paguar nga DEP.

1. Autorizimi i pagesave për projektet e Programit IPARD II

- Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, janë dorëzuar pranë DAP për autorizim të pagesës së plotë 2 projekte nga Thirrja e I-rë IPARD në vlerën 47 mln lekë. Gjatë kësaj periudhe, janë autorizuar për pagesë 4 projekte në vlerën 65 mln lekë.
- Gjithashtu, janë dorëzuar pranë DAP për autorizim të pagesës së plotë 40 projekte nga Thirrja e II-të IPARD në vlerën 828 mln lekë dhe janë autorizuar për pagesë 50 projekte në vlerën 1.02 mld lekë.
- Për Thirrjen e III-të, janë dorëzuar pranë DAP për autorizim të pagesës së plotë 62 projekte në vlerën 712 mln lekë dhe janë autorizuar për pagesë 55 projekte në vlerën 602 mln lekë, gjithashtu janë dorëzuar për autorizim të parapagesës 10%-50%, 67 projekte në vlerën 524 mln lekë dhe janë autorizuar për pagesë 66 projekte në vlerën 499 mln lekë.
- Gjithashtu, janë dorëzuar pranë DAP për autorizim të pagesës së plotë 3 projekte për Masën 9, në vlerën 10 mln lekë. Gjatë kësaj periudhe, është autorizuar për pagesë 3 projekte në vlerën 10 mln lekë.
- Për Thirrjen e IV, janë dorëzuar pranë DAP për autorizim të parapagesës 10%-50%, 17 projekte në vlerën 90 mln lekë. Gjatë kësaj periudhe, janë autorizuar për pagesë 14 projekte në vlerën 73 mln lekë.
- Gjithashtu, janë dorëzuar pranë DAP për autorizim të pagesës pjesore, 12 projekte në vlerën 171 mln lekë. Gjatë kësaj periudhe, është autorizuar për pagesë 3 projekte në vlerën 63 mln lekë.

Për sa më sipër, më poshtë janë paraqitur tabelat për projektet e autorizuara në Programin IPARD II:

Tabela nr 8: Autorizimet thirrja parë IPARD II

	Kërkesa të autorizuara - Viti 2022			
	Janar-Dhjetor 2022	KpP në Nr.	Vlera në Leke	Vlera në Euro
THIRRJA I - te PLOTA	Janar	0	0.00	0.00 €
	Shkurt	2	24,596,654.15	203,177.38 €
	Mars	0	0.00	0.00 €
	Prill	0	0.00	0.00 €
	Maj	0	0.00	0.00 €
	Qershor	1	13,179,464.06	109,911.30 €
	Korrik	0	0.00	0.00 €
	Gusht	0	0.00	0.00 €
	Shtator	0	0.00	0.00 €
	Tetor	1	27,855,563.54	239,473.55 €
	Nentor	0	0.00	0.00 €
	Dhjetor	0	0.00	0.00 €
	Totali	4	65,631,681.75	552,562.24 €

	Kërkesa të autorizuara - Viti 2021			
	Janar-Dhjetor 2021	KpP në Nr.	Vlera në Leke	Vlera në Euro
THIRRJA I - te PLOTA	Janar	9	340,137,788	2,767,148 €
	Shkurt	2	31,840,898	257,592 €
	Mars	6	196,712,553	1,591,525 €
	Prill	6	165,101,457	1,338,913 €
	Maj	2	125,850,223	1,021,263 €
	Qershor	2	159,322,262	1,294,356 €
	Korrik	3	48,799,185	398,068 €
	Gusht	0	929,250	7,614 €
	Shtator	3	42,239,655	346,738 €
	Tetor	0	0	0 €
	Nentor	2	32,299,182	264,856 €
	Dhjetor	3	115,093,850	949,698 €
	Totali	38	1,258,326,303	10,237,771 €

Tabela nr 9: Autorizimet thirrja dytë IPARD II

	Kërkesa të autorizuara - Viti 2022
--	------------------------------------

	Janar-Dhjetor 2022	KpP në Nr.	Vlera në Leke	Vlera në Euro
THIRRJA II - te PLOTA	Janar	2	29,101,807.85	241,729.44 €
	Shkurt	4	137,000,649.88	1,131,675.61 €
	Mars	9	103,241,662.19	851,407.41 €
	Prill	5	115,704,267.30	946,843.43 €
	Maj	2	28,620,990.69	237,498.89 €
	Qershor	6	78,294,035.12	652,940.00 €
	Korrik	1	42,407,304.02	355,140.31 €
	Gusht	2	32,736,574.07	280,735.56 €
	Shtator	1	91,297,082.22	781,720.03 €
	Tetor	4	79,086,601.31	679,905.44 €
	Nentor	5	105,113,824.23	893,977.07 €
	Dhjetor	9	176,835,176.30	1,513,740.59 €
	Totali	50	1,019,439,975.18	8,567,313.79 €

	Kërkesa të autorizuara - Viti 2021			
	Janar-Dhjetor 2021	KpP në Nr.	Vlera në Lekë	Vlera në Euro
THIRRJA II - te PLOTA	Janar	4	18,181,878	147,916 €
	Shkurt	10	82,978,153	671,290 €
	Mars	13	57,187,703	462,684 €
	Prill	14	73,799,513	598,325 €
	Maj	9	87,264,226	708,141 €
	Qershor	6	26,839,892	218,051 €
	Korrik	3	48,237,160	393,484 €
	Gusht	4	31,852,538	261,001 €
	Shtator	6	50,890,140	417,749 €
	Tetor	7	116,810,522	961,324 €
	Nentor	13	193,087,590	1,583,334 €
	Dhjetor	7	156,484,977	1,291,237 €
	Totali	96	943,614,292	7,714,536 €
	Kërkesa të autorizuara - Viti 2021			
	Janar-Dhjetor 2021	KpP në Nr.	Vlera në Leke	Vlera në Euro
THIRRJA II - 10%	Janar	1	1,177,701	9,581 €
	Shkurt	2	3,929,037	31,786 €
	Totali	3	5,106,738	41,367 €
	Kërkesa të autorizuara - Viti 2021			

	Janar-Dhjetor 2021	KpP në Nr.	Vlera në Leke	Vlera në Euro
THIRRJA II - 20%-50%	Janar	8	34,283,455	278,909 €
	Shkurt	26	125,704,246	1,016,942 €
	Mars	21	259,443,025	2,099,053 €
	Prill	8	60,066,409	487,117 €
	Maj	3	19,707,975	159,928 €
	Qershor	5	82,797,386	672,657 €
	Korrik	1	4,254,920	34,708 €
	Gusht	3	11,432,488	93,678 €
	Shtator	4	33,079,782	271,546 €
	Tetor	1	12,846,576	105,724 €
	Nentor	1	11,090,909	90,946 €
	Totali	81	654,707,171	5,311,208 €

Tabela nr 10: Autorizimet thirrja trete IPARD II

	Kërkesa të autorizuara - Viti 2022			
	Janar-Dhjetor 2022	KpP në Nr.	Vlera në Leke	Vlera në Euro
THIRRJA III - te PLOTA	Janar	0	0	0.00 €
	Shkurt	0	0	0.00 €
	Mars	2	11,405,771.06	94,060.46 €
	Prill	2	21,073,581.31	172,451.57 €
	Maj	3	9,352,745.65	77,609.71 €
	Qershor	5	73,619,359.42	613,955.13 €
	Korrik	2	14,079,383.91	117,907.91 €
	Gusht	8	93,100,462.64	798,391.76 €
	Shtator	8	71,314,220.37	610,619.23 €
	Tetor	6	94,974,093.32	816,489.80 €
	Nentor	11	61,482,791.35	522,901.78 €
	Dhjetor	8	152,364,603.87	1,304,268.14 €
Totali	55	602,767,012.90	5,128,655.48 €	

Tabela nr 11: Autorizimet thirrja trete 10-50% IPARD II

	Kërkesa të autorizuara - Viti 2022			
	Janar-Dhjetor 2022	KpP në Nr.	Vlera në Leke	Vlera në Euro

THIRRJA III - 10%-50%	Janar	6	32,878,457.71	273,099.57 €
	Shkurt	9	50,531,078.99	417,405.25 €
	Mars	3	21,098,447.70	173,993.47 €
	Prill	8	46,343,000.36	379,238.96 €
	Maj	9	96,080,820.15	797,285.04 €
	Qershor	14	182,933,322.78	1,525,588.55 €
	Korrik	3	10,039,118.00	84,072.67 €
	Gusht	8	26,310,100.72	225,624.74 €
	Shtator	2	14,813,670.30	126,840.23 €
	Tetor	1	3,166,203.00	27,219.76 €
	Nentor	3	15,394,346.12	130,926.57 €
	Dhjetor	0	0.00	0.00 €
	Totali	66	499,588,565.83	4,161,294.80 €

Tabela nr 12: Autorizimet Masa 9 IPARD II

	Kërkesa të autorizuara - Viti 2022			
	Janar-Dhjetor 2022	KpP në Nr.	Vlera në Leke	Vlera në Euro
Masa 9	Maj	1	1,444,156.67	11,983.71 €
	Tetor	1	8,389,350.00	72,123.02 €
	Nentor	1	299,849.00	2,550.17 €
	Totali	3	10,133,355.67	86,656.90 €

Tabela nr 13: Autorizimet Masa 9 IPARD II

	Kërkesa të autorizuara - Viti 2022			
	Janar-Dhjetor 2022	KpP në Nr.	Vlera në Leke	Vlera në Euro
THIRRJA IV 10% 50%	Shtator	2	10,981,686.00	94,029.33 €
	Tetor	0	0.00	0.00 €
	Nentor	1	6,187,713.80	52,625.56 €
	Dhjetor	11	55,887,107.39	478,937.98 €
	Totali	14	73,056,507.19	625,592.88 €

	Kërkesa të autorizuara - Viti 2021			
	Janar-Shtator 2021	KpP në Nr.	Vlera në Leke	Vlera në Euro
Masa 9	Nentor	1	305,000	2,501 €
	Dhjetor	1	6,931,564	57,196 €
	Totali	2	7,236,564	59,697 €

Tabela nr 14: Autorizimet Pjesore IPARD II

	Kërkesa të autorizuara - Viti 2022

	Janar-Dhjetor 2022	KpP në Nr.	Vlera në Leke	Vlera në Euro
Pjesore	Tetor	0	0.00	0.00 €
	Nentor	1	32,824,620.73	279,168.40 €
	Dhjetor	2	30,827,395.84	263,888.00 €
	Totali	3	63,652,016.57	543,056.40 €

2. Autorizimi i pagesave për Skemat Kombëtare 2022

Bazuar në Udhëzimin Nr.1, datë 11.02.2022 “Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, Drejtoria e Autorizimit të Pagesave ka kryer procesin e autorizimit të pagesave për periudhën “Janar-Dhjetor” 13,947 dosje, me vlerë 2,886,210,387 lekë si dhe gjashtë investime të prapambetura viti 2021 me vlerë 31,534,169 lekë

Gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2022, DAP/SK ka kryer konkretisht detyrat e mëposhtme:

- Autorizimi i pagesave të projekteve në kuadër të skemave direkte
- Menaxhimi i skemës së naftës, prodhimi i kartave sipas listave të përfituesve, kontrolli, verifikimi dhe shpërndarja e sasisë së litrave dhe kartave të fermerëve.
- Përgatitja e Raportimit mbi Realizimin e Pagesave për Masat Direkte mbështëse që përfituan nga fondi i programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural për Vitin 2022, sipas skemave dhe Qarqeve, mbi bazën e Akt -Rakordimeve me DEP për të gjithë aplikimet dhe përfituesit përkatës.
- Janë shqyrtuar ankesat dhe pretendimet e aplikanteve, verifikimin dhe kthim pergjigjet me sqarimet perkatese.
- Realizimin në afat dhe me cilësi të të gjitha detyrave funksionale të përshkruara në përshkrimet e pozicioneve të punës.

Projektet e autorizuara, të shpërndara sipas masave dhe vlerat përkatëse paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr 115: Autorizimi i pagesave per Skemat Kombëtare sipas Masave

Raporti SKEMAT KO MBETARE 2022

Nr. Masave referues ne udhezim	MASAT PERFITIMIT	APLIKIME-kerkesa		Buxheti sipas Rialok. Ur.173 , date 14.04.2022		Autorizim		Fond Mbetur	% realiz.
		Nr.aplik.	Vlere	Nr.aplik. ulj a e vijes 29.09.2022	Vlere	Nr.aplikant	vlerë		
1	Mbeshetjetje per fara/fidane dhe inpute te tjera	813	491,956,400	813	181,453,780	771	181,453,780	-	100%
2	Mbeshetjetje ndertim serra diellore	6	124,507,630	1	12,999,513	1	12,912,818	86,695	99%
3	Mbjellje bime mjekesore aromatike	908	383,409,780	187	100,656,400	175	100,656,400	-	100%
4	Ferme organike	246	37,850,000	98	11,200,000	70	10,800,000	400,000	96%
5	Çertifikimi global GAP	56	17,600,000	56	736,209	3	348,097	388,112	47%
6	Mbeshetjetje per tufen baze te matrikuluar	7,015	1,787,793,200	6,112	1,521,078,627	6,128	1,492,969,200	28,109,427	98%
7	Mbeshetjetje per mbareshttrim bletarie	2,933	331,188,000	2,889	295,237,000	2,680	288,892,000	6,345,000	98%
7.1	Mbeshetjetje per kultivimin e grurit	7,466	906,946,515	4,200	468,884,043	3,965	448,720,761	20,163,282	96%
7.2	Mbeshetjetje me 40 lek/liter per nafte anije peshkimi	190		190	200,000,000	131	200,000,000	0	100%
8	Blerje anije peshkimi								0%
9	Rinovim infrastruktures anijes peshk. blerje instalime	54	270,421,461	25	149,457,331	23	149,457,331	0	100%
12	Mbeshetjetje per automatizimin dhe digjitalizimin e proceseve te punes ne ferme	5	10,087,155	1	0			-	0%
TO TALI I		19,692	4,361,760,141	14,572	2,941,702,903	13,947	2,886,210,387	55,492,516	93%
	Pagesa invest. të prapamb. Viti 2021	7	37,600,872	6	31,534,169	6	31,534,169	-	100%
	Normë Interesi	1	50,000	1	26,458	1	26,119	339	99%
TO TALI II		8	37,650,872	7	31,560,627	7	31,560,288	339	
TO TALI		19,700	4,399,411,013	14,579	2,973,263,530	13,954	2,917,770,675	55,492,855	99%

V. DREJTORIA E EKZEKUTIMIT TË PAGESAVE (DEP)

Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave (DEP), është përgjegjëse për organizimin dhe implementimin e funksioneve të ekzekutimit të pagesave direkte tek përfituesi, për skemat kombëtare, IPARD, dhe të sigurojë transferimin e fondeve te përfituesit e investimeve nga programe të ndryshme financimi.

Kjo drejtori është përgjegjëse për ekzekutimin e pagesave në kohë dhe me cilësi të lartë duke bashkërenduar punën me Drejtorinë e Kontrollit, Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, me Banka të nivelit të dytë dhe me Thesarin e Shtetit.

D. Sektori i Ekzekutimit të Pagesava (SEP) – Kombëtare

Sektori i Ekzekutimit të Pagesave për skemat kombëtare është përgjegjëse për ekzekutimin e pagesave direkte tek përfituesi.

Objektivat:

- Ekzekutimin e pagesave (të prapambetura të vitit 2021 dhe skemat e rehat për vitin 2022) në kohë dhe me saktësi duke bashkërenduar punën me Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, Drejtorinë e Financës si dhe evidentimin e çdo detyrimi debitor para pagese.
- Listat e aplikimeve të autorizuara për pagesë plotësohen/përditësohen me kodin e fermës së aplikantit përfitues nga AREB-et.
- Lista e autorizuar për pagesë e plotësuar me kodin e fermës dërgohet për importim në Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të Skemave Kombëtare, Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe suportit.
- Bllokimin e aplikantëve që rezultojnë debitorë ndaj AZHBR deri në momentin e shlyerjes së detyrimeve financiare.
- Përgatitja e Urdhër-Shpenzimeve në përputhje me listën e projekteve të autorizuara për pagesë nga DAP.
- Hedhjen në Sistemin e Menaxhimit të Skemave dhe në Sistemin Financiar të Qeverisë të gjitha angazhimet dhe shpenzimet e kryera nga AZHBR nën llogarinë 606 (Subvencionet). Përgjegjësi i SEP mbas miratimit të list pagesave nga NZ dhe NA rregjistron në SIFQ pagesën dhe ndjek miratimin e saj sipas hirarkisë.
- Kryerjen e rakordimeve dhe raportimeve të ndryshme me DAP, DF për projektet e autorizuara dhe të financuara duke ruajtur gjithnjë limitet e çelura të fondit të planifikuar në fillim të vitit me alokimet e tij, sipas skemave mbështetëse.

Realizimi

Në kuadër të implementimit të masave mbështetëse të financuara nga buxheti i shtetit për vitin 2021 dhe fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural 2022, Sektori i Ekzekutimit të Pagesave Kombëtare, gjatë periudhës raportuese Janar–Dhjetor 2022 ka realizuar konkretisht detyrat e mëposhtme:

1. Në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të AZHBR, kemi kryer mbylljen e veprimeve financiare për vitin 2021 dhe 2022, përgatitjen e raportit vjetor 2022, si dhe pritshmëritë për vitin 2023.
2. Njohjen me VKM Nr.101, datë 09.02.2022 “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural, për vitin 2022” si dhe me udhëzimin Nr.01, datë 11.02.2022 të MBZHR dhe MFE, dhe në zbatim të Manualit të Procedurave”.
3. Njohja me VKM Nr.556 , datë 29.07.2022 dhe udhëzimin Nr.14, datë 01.08.2022.
4. Realizimin e rakordimeve me Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave për skemat mbështetëse të vitit 2021 dhe 2022 për numrin e aplikimeve të autorizuara dhe të financuara.
5. Pjesëmarrja në trajnime të ndryshme të realizuara nga ASPA dhe në grupe pune të ngritura nga AZHBR.
6. Ndarjen dhe sistemimin e dosjeve të projekteve të financuara sipas qarqeve, për skemat e vitit 2021 dhe 2022.
7. Angazhimi dhe bashkëpunimi me zyrën juridike për sqarimin dhe dhënien e përgjigjeve zyrtare të ankesave të ndryshme, kërkesave për informacion, të aplikantëve të viteve të kaluara.
8. Përgatitja dhe përpunimi i të dhënave sipas formateve të kërkuara nga Sektori i Monitorimit dhe Sektori i Promocionit dhe Komunikimit.
9. Përgatitja e listës totale emërore të përfitues ndarë sipas qarqeve dhe skemave për publikim në faqen e Web-it :www.azhbr.gov.al.

Subvencionimi i skemave kombëtare për vitin 2022 shënon këto arritje:

• Aplikime të financuara skema direkte	13,913 me vlerë	2,883,945,021 lekë
• Aplikime pezull pa iban masa 7/1 Jashte vendit	5 me vlerë	204,900 lekë
• Aplikime të autorizuar pa iban 21 masa 7/debitor	24 me vlerë	2,479,400 lekë
• Aplikime të autorizuar skualif. dok. masa 1 probleme	6 me vlerë	422,040 lekë
• Aplikime të autorizuar gabim gjithsej	3 me vlerë	741,000 lekë
• Memo kredi	2 me vlerë	1,045,000 lekë
• 1. Totali skema e reja	13,913 me vlerë	2,883,990,021 lekë
• 2. Subvencionim nafte	34,731 me vlerë	1,949,991,029 lekë
• 3. Investime të v.2021 dhe Normë interesi	7 me vlerë	31,560,288 lekë
• 4. Investime 2022 masa 9	23 vlerë	150,296,759 lekë
• 5. Transferta 604	5 me vlerë	182,088,642 lekë

Tabela nr 16: Ekzekutimi i pagesave per Skemat Kombëtare sipas Masave

Nr. Masave referues ne udhezim	MASAT E PERFITIMIT	APLIKIME-kerkesa		Buxheti sipas Ri-Alok.3 Ur.597 , date 15.12.2022&AN		% e mbulimit te aplikimeve te rregullta	Realizimi	
		Nr.aplik.	Vlere	Nr.aplik.	Vlere		Nr.perf.	vlerë
1	Mbeshtetje per fara/fidane dhe inpute te tjera	813	491,956,400	813	181,453,780	37%	771	181,453,780
2	Mbeshtetje ndertim serra diellore	6	315,646,253	1	12,912,818	100%	1	12,912,818
3	Mbjellje bime mjekesore aromatike	908	383,409,780	187	100,721,134	26%	174	100,656,400
4	Ferme organike	246	37,850,000	98	10,800,000	29%	70	10,800,000
5	Çertifikimi global GAP	56	17,600,000	56	348,097	2%	3	348,097
6	Mbeshtetje per tufen baze te matrikuluar	7,015	1,787,793,200	6,170	1,510,119,551	84%	6,125	1,491,801,200
7	Mbeshtetje per mbareshtim bletarie	2,933	331,188,000	2,960	293,164,322	89%	2,682	289,057,000
7,1	Mbeshtetje per kultivimin e grurit	7,464	906,946,515	3,860	468,884,037	52%	3,939	446,618,967
7,2	Mbeshtetje me 40(dyzet)leke per liter karburant per anije peshkimi	190		190	200,000,000		125	200,000,000
8	Blerje anije peshkimi							
9	Rinovim infras. anijes peshkimi	54	270,421,461	25	162,547,331	60%	23	150,296,759
12	Mbeshtetje per automatizimin dhe digjitalizimin	5	10,087,155	1	-	0%		

	e proceseve te punes ne ferme							
	NEN TOTALI 606	19,690	4,552,898,764	14,361	2,940,951,070	65%	13,913	2,883,945,021
10	Mbeshtetje per ndertimin e tregjeve PB(604)	9	259,253,201	6	132,088,642		5	132,088,642
11	Mbeshtetje e nje skeme trajnimi ne bujqesi dhe ngritjen e qendres se ekselences te UBT	1	50,000,000		50,000,000			50,000,000
	Pagesa invest. të prapamb. Viti 2021	7	37,600,872	6	31,534,169	84%	6	31,534,169
	Normë Interesi	1	50,000	1	26,119		1	26,119
	NEN TOTALI 2 llog. 606	8	37,650,872	7	31,560,288		7	31,560,288
	TOTALI 606 THESAR				2,972,511,358		13,920	2,915,505,309
	TOTALI 606+604	19,698	4,849,802,837	14,374	3,154,600,000		13,925	3,097,593,951
13	Mbeshtetje me nafte per kryerjen e punimeve (NAFTA TOT.3) kod projekti 90505AL	49,654	3,220,000,000		1,949,998,000	61%	34,731	1,949,991,029
	TOTALI				5,104,598,000		48,656	5,047,584,980

E. Sektori i Ekzekutimit të Pagesave IPARD

Në kuadër të Projektit **IPARD II** dhe, Sektori i Ekzekutimit të Pagesave IPARD, gjatë periudhës raportuese Janar –Shtator ka kryer konkretisht detyrat e mëposhtme:

- Përgatitja e kërkesës për fonde (ROF) bazuar në kërkesat për pagesë nga Drejtoria e Autorizimit.
- Rakordimi me Fondim Kombëtar për fondet e kërkuara dhe pagesat.
- Përgatitjen e Urdhër-Shpenzimeve për bashkefinancimin 25% në përputhje me listën e projekteve të autorizuara për pagesë nga DAP.
- Përgatitja e Urdhër xhirimeve drejtuar Bankes Intesa, ku finalizohet pagesa.
- Ekzekutimin e pagesave në kohë dhe me cilësi të lartë të të gjithë projekteve të aprovuara.
- Ekzekutimin e pagesave të autorizuara, lidhur me Projektin e IPADR II.
- Raportimin mbi bazë mujore dhe javore për Ministrinë e Financave dhe të Bujqësisë lidhur me programin IPARD II.
- Raportimin mbi bazë mujore, 3 mujore, 6 mujore, 9 mujore, 12 mujore tek oficeri i raportimit.
- Realizimin në afat dhe me cilësi të të gjitha detyrave funksionale të përshkruara në përshkrimet e pozicioneve të punës.
- Bashkërendimin e punës me Drejtoritë e tjera përkatëse të AZHBR-së, si Drejtorinë e Kontrollit, Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, Drejtorinë e Financës dhe Sektorin e Riskut.

Gjatë muajve Janar-Dhjetor të vitit 2022, sektori i DEP IPARD ka zbatuar:

Zbatimi i politikave të integritetit evropian dhe programeve të zhvillimit bujqësor dhe rural me qëllim arritjen e objektivave strategjike kombëtare për arritjen e standardeve evropiane në mbështetje të fermerëve dhe ndërmarrjeve agropërpunuese, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Sepsi duhet të ndjehet dhe zbatohet përputhshmerine e standardeve teknike kombetare dhe të BE-se në lidhje me ekzekutimin e pagesave IPARD.

Gjatë muajve Janar –Dhjetor 2022, sektori i ekzekutimit të pagesave ka regjistruar **116** kontrata, të cilat janë regjistruar në përputhje me Manualin e procedurave për Sektorin e Ekzekutimit të Pagesave në dokumentat e mëposhtem:

1. Librin e hyrjeve
2. Regjistri i perfituesve
3. Lista e dokumentave levizese
4. Regjistri i kontratave
5. Lista e perfituesve
6. Libri i daljeve

Për këto kontrata janë përllogaritur shumat që do të ekzekutohen sipas afatave të përcaktuara në to, përkatësisht në dokumentat e mëposhtëm:

7. Alokimi i fondeve IPARD
8. Parashikimi i fondeve.

Në përputhje me procedurat e miratuara dhe manualët përkatës, janë dërguar tek Fondi Kombëtar në MFE (NF) dhe miratuar kërkesat për Fonde duke u mbështetur tek njoftimet për parapagese dhe të njoftimet për pagesë nga drejtoria e autorizimit të pagesave.

Gjatë Periudhes Janar-Dhjetor 2022 janë kryer gjithsej 31 Kërkesa për Fonde ne shumen totale 2,319,949,520 lekë, të cilat janë miratuar nga Fondi Kombëtar brenda afateve.

Pas miratimeve për kalimin e fondeve përkatesisht 25% nga thesari i shtetit dhe 75% nga BE në llogarinë e bankës së nivelit të dytë jane ekzekutuar 200 pagesa, nga te cilat 84 jane paradhënie dhe 116 janë pagesa të plota.

Më poshtë 3 tabela përmbledhëse me pagesat e pjeshme dhe të plota të kryera gjatë periudhes Janar –Dhjetor 2022, te ndara sipas masave:

Tabela nr 17: Ekzekutimi I pagesave sipas masave IPARD II

Pagesa pjesore % Janar – Dhjetor				
MASAT	Nr.	NCF	EU	TOTAL
M 1	59	76,882,172.92	230,646,518.75	307,528,691.66
M 3	11	64,133,274.70	192,399,824.09	256,533,098.79
M 7	14	18,264,126.80	54,792,380.40	73,056,507.20
M 9	0	0	0	0
Totali	84	159,279,574.41	477,838,723.24	637,118,297.65
Pagesa 100% Janar – Dhjetor				
MASAT	Nr.	NCF	EU	TOTAL
M 1	69	200,899,687.69	602,699,063.05	803,598,750.74
M 3	17	122,975,937.67	368,927,813.00	491,903,750.67
M 7	27	94,298,841.54	282,896,524.61	377,195,366.14
M 9	3	1,520,003.35	8,613,352.32	10,133,355.67
Totali	116	419,694,470.25	1,263,136,752.98	1,682,831,223.22
Pagesa pjesore + 100% Janar – Dhjetor				
MASAT	Nr.	NCF	EU	TOTAL
M 1	128	277,781,860.61	833,345,581.80	1,111,127,442.40
M 3	28	323,875,625.36	971,626,876.05	748,436,849.46
M 7	41	112,562,968.34	337,688,905.01	450,251,873.34
M 9	3	1,520,003.35	8,613,352.32	10,133,355.67
Totali	200	578,974,044.66	1,740,975,476.21	2,319,949,520.87

Gjatë kësaj periudhe është punuar edhe me përditësimin e Manualeve të procedurave të sektorit të Ekzekutimit të Pagesave, me qëllim harmonizimin e procedurave dhe tabelave me departamentet e tjera dhe Fondin Kombëtar.

VI. DREJTORIA E KONTROLLIT

Për vitin 2022, prioriteti i Drejtorisë së Kontrollit ka qenë kryerja e kontrolleve në terren për skemat kombëtare dhe ato IPARD si dhe çdo skemë tjetër mbështetëse që implementon Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, për identifikimin e kritereve dhe përputhshmërinë e aplikimeve duke i paraqitur ato me formularë verifikimi ose raporte kontrolli.

Spektori i Kontrollit IPARD

Spektori IPARD është përgjegjës për kryerjen e kontrolleve në terren në përputhje me Manualin e Procedurave për programet e para-aderimit të Shqipërisë në BE për bujqësinë si dhe kontrolleve për çdo skemë tjetër mbështetëse që implementon AZHBR-ja.

Për realizimin e kontrolleve në terren, konform procedurave të miratuara, Spektori i Kontrollit IPARD bashkëpunon me Drejtorinë e Përzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve për realizimin e kontrolleve para miratimit të projekteve dhe me Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave për realizimin e kontrolleve para financimit të projekteve.

Organizon dhe ndjek programin e kontrolleve bazuar në procedurat e realizimit të kontrolleve:

- Para lidhjes së kontratës.
- Para pagese dhe kontrolle të ndërmjetme.
- Kontrolle shtesë lidhur me parregullsitë e konstatuara, ose ankesat e ardhura pranë AZHBR.

Nga Spektori Ipard janë realizuar gjithësej kontrollet si më poshtë:

Për periudhën **Vitin 2022**, për projektet e financuara nga Programi IPARD II janë realizuar kontrollet si më poshtë:

- ✓ **33 kontrole** para pagesë në kuadër të thirrjes së parë IPARD II
- ✓ **1 kontroll** i ndërmjetem në kuadër të thirrjes së parë IPARD II
- ✓ **40 kontrole** para pagesë në kuadër të thirrjes së dytë IPARD II
- ✓ **57 kontrole** të ndërmjetme në kuadër të thirrjes së dytë IPARD II
- ✓ **143 kontrole** të ndërmjetëm në kuadër të thirrjes së tretë IPARD II
- ✓ **48 kontrole** para kontraktimi në kuadër të thirrjes së tretë IPARD II
- ✓ **48 kontrole** para pagesë në kuadër të thirrjes së tretë IPARD II
- ✓ **17 kontrole** të ndërmjetëm në kuadër të thirrjes së katërt IPARD II
- ✓ **32 kontrole** para kontraktimi në kuadër të thirrjes së tretë IPARD II

Total realizuar **390 kontrole** për vitin **2022** për projektet e financuara nga Programi IPARD II.

Sektori i Kontrollit për Skemat Kombëtare:

Sektori i Kontrollit është përgjegjës për kryerjen e verifikimeve në terren të aplikimeve për skemat kombëtare të cilat financohen në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara në Udhëzimin e përbashkët të MBZHR dhe MF, Rregullores së Brendshme të AZHBR-së dhe Manualit të Procedurave për Skemat Kombëtare.

Aktivitetet kryesore të Sektorit të Kontrollit për Skemat Kombëtare

Gjatë periudhës Janar– Dhjetor 2022, Sektori i Kontrollit për Skemat Kombëtare ka realizuar aktivitetet si më poshtë:

- Gjatë kësaj periudhe janë realizuar 17,780 **verifikime** në terren, nga të gjitha skemat kombëtare.
- Nga numri gjithsej i verifikimeve të realizuara në terren 14,320 aplikimeve të shpallura në listat paraprake të fituesve të masave të financuara nga buxheti i shtetit për vitin 2022, janë të dorëzuara në DAP se bashku me formularet e verifikimit dhe dokumentet shoqeruese, (masat me 0 dokumenta në momentin e aplikimit).
- Këtë vit për herë të parë, në mbështetje të Udhëzimit Nr. 14 datë 01.08.2022 është shtuar edhe msa 7.1 "mbështetje për kultivimin e grurit për sipërfaqe të mbjellë jo më pak se 1 ha në vlerën 30,000 lekë për ha".

Aplikimet e realizuara sipas masave mbështetëse financiare të cilat janë dorëzuar në DAP paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr 18: Kontrollat e kryera sipas masave

Nr	Skema	Kontrolle direkte
1	1.Mbështetje për fara/fidanë e impute të tjera	426
2	3.Mbështetje për kultivimin e BAM	177
3	6. Per tufen baze te matrikulluar	6,466
4	7. Mbareshtimi i bletarise	2,795
5	4.1 Fermat Organike - Viti i parë	15
6	4.2 Fermat Organike - Viti i dytë	10
7	4.3 Fermat Organike - Viti i tretë	22
8	4.4 Fermat Organike - ferme e certifikuar	22
9	5. Identifikimi dhe certifikimi Global GAP	5
10	7,1 Mbeshtetje per mbjellje gruri	4,382
TOTALI		14,320

- Në zbatim të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe ministrisë Ekonomisë dhe Financave , “Për përcaktimin e kriterëve bazë të sektorëve që do të mbështeten dhe masës së financimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”, Inspektorët e Sektorit të Kontrollit kanë kryer kontrollin e aplikimeve të skemës së naftës. Nga DPAP dhe nga SMI janë përzgjedhur aplikimet për kontroll. Përzgjedhja e aplimeve është jo më pak se 10 % e aplikimeve të përfshira në vijën e financimit pas kontrollit administrativ. Gjatë këtij viti janë kryer kontrolle sipas qarqeve e bashkive në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr 19: Kontrollët e kryera sipas Qarqeve per skemen e naftes

Nr	Ndarjet sipas Qarqeve dhe Bashkive	Kontrolle direkte
1	Berat	471
2	Dibër	155
3	Durrës	176
4	Tiranë	41
5	Elbasan	365
6	Fier	369
7	Lushnje	630
8	Gjirokastër	78
9	Korça	794
10	Kukës	21
11	Lezhë	26
12	Shkodër	190
13	Vlorë	108
14	Sarandë	36
Shuma		3,460

Nga kontrolli përcaktohen aplikimet të cilat kanë rezultuar në terren, sipas aplikimit nga fermerët, si dhe ata që kanë devijim në mbjellje mbi 20 % nga sipërfaqja e deklaruar ne aplikim.

VII. DREJTORIA E MONITORIMIT TE SKEMAVE, RISKUT DHE RAPORTIMIT

Sektori i Monitorimit

Objekti dhe detyrat e Sektorit Monitorimit janë mbështetur në zbatim të kërkesave të Nenin 21 të Ligjin Nr.9817, datë 22.10.2007, “Për bujqësinë dhe Zhvillimin Rural”, në VKM-në Nr.190 datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillimin Bujqësor dhe Rural, në “Manualin e procedurave për implementimin e skemave kombëtare” si dhe në Manualin e procedurës së punës së Sektorit të Monitorimit. SMS në rolin dhe misionin e tij, mundëson informacion në një nivel më të lartë për mënaxhimin, efektshmërinë dhe transparencën për zbatimin e politikave të AZHBR-së për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural.

a) Më poshtë po ju paraqesim disa nga pikat kryesore dhe detyrat e përditshme që kryejnë inspektorët e Sektorit Monitorimit në DSMRR:

- Harton dhe zbaton planin operativ për monitorimin e projekteve në terren, të financuara nga fondet kombëtare, Bashkimit Europian, Bankës Botërore, si dhe vendeve të tjera donatorë për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural në Shqipëri.
- Tërheq dhe studion dosjen e projekteve që do të monitorohen bazuar në analizën e riskut për secilin projekt të financuar.
- Lajmëron aplikantët për kontrollin verifikues që do të kryhet jo më shumë se 48 orë para kontrollit sipas formularit.
- Realizon kontrollin ex-post në terren të projekteve dhe plotëson formularët përkatës.
- Analizon rezultatet e monitorimit, përgatit dhe miraton raportet e monitorimit.
- Raportet e monitorimit së bashku me memon bashkëngjitur ja dërgon Drejtorit të Kontrollit, Drejtorisë së Autorizimit Pagesave, Sektorit të Riskut si dhe Drejtoreshës së Përgjithshme.
- Krijon dhe mban një informacioni të azhurnuar mbi projektet e monitoruara dhe aktivitetin e sektorit.
- Zbaton dhe raporton detyra të tjera të ngarkuara nga Drejtori i Kontrollit dhe Drejtori i Përgjithshëm.

b) Në vazhdimësi po ju paraqesim çështjet ku përqëndrohet SM gjatë kontrolleve të monitorimit në terren:

- Nëse investimi është ende ekzistues dhe funksional sipas kontratës së nënshkruar
- Nëse investimi është në përdorim sipas qëllimit fillestar
- Nëse janë bërë ndryshime në projekt në krahasim me kontratën e nënshkruar
- Nëse përfituesi është pronari aktual i investimit
- Nëse projekti i financuar ka dhënë efekte tek ecuria e të ardhurave të objektit
- Nëse projekti i financuar ka dhënë efekte tek ecuria e prodhimit të aktivitetit
- A ka ndikuar financimi i përfituar tek rritja e fuqisë punëtore
- A janë përmbushur objektivat e parashikuara në biznes planin për të cilat është dhënë mbështetje financiare
- Nëse asetet e financuara janë evidentuar në librat e kontabilitetit të kompanisë
- Nëse janë ruajtur rregullat e vizibilitetit për bashkëfinancimin e fondeve kombëtare

- c) Në vazhdimësi po ju paraqesim në mënyrë të detajuar, të përgjithshme dhe individuale për çdo inspektor, të gjitha kontrollet e realizuar nga SM:

Aktivitetet kryesore të Sektoreve të Monitorimit gjatë vitit 2022 janë listuar si më poshtë:

- Ka kryer **35 kontrole ex-post** për projektet përfituese nga “**Investime të Skemave Kombëtare**” në zbatim të Manualin të Proçedurës së Sektorit Monitorimit Skemave.
- Ka kryer **46 kontroll ex-post** për projektet përfituese nga programi “**IPARD II**”.
- Është punuar intensivisht për saktësimin/përditësimin e kontakteve për përfituesit e të gjitha fondeve ndër vite në databazën e sektorit.
- Është punuar intensivisht për plotësimin me tabelën e vizibilitetit për të gjitha subjektet përfituese ndër vite, si dhe për ri-dërgimin e atyre që nuk e kanë ose ju është dëmtuar.
- Është punuar intensivisht për plotësimin dhe dërgimin e shkresave njoftuese për detyrimet kontraktuale tek të gjitha subjektet përfituese nga Programi IPARD II dhe Skema Kombëtare 2019/ 2020.
- Përgjegjësja e sektorit ka bashkëpunuar me përgjegjësit e tjerë të DK për të plotësuar raporte / kthim-pergjigje, materiale të ndryshme, etj për SM dhe DK.
- Përgjegjësja e sektorit dhe 3 inspektorë angazhuar si mbështetje në agropika, gjatë periudhës 23 Shkurt – 09 Mars 2022, për procesin e aplikimeve të Skemave Kombëtare/Naftë.

Sektori i Riskut dhe Raportimit

Sektori i Riskut dhe Raportimit është përgjegjës për bashkërendimin e aktiviteteve lidhur me riskun e Agjencisë për arritjen e objektivave analizën dhe raportimin e aktiviteteve të AZHBR-së sipas procedurës së Raportimit.

Gjithashtu SRR kryen të gjitha detyrimet dhe raportimet në cilësinë e Strukturës Përgjegjëse për Sinjalizimin, Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesave” për AZHBR-në, të ngritur me Urdhërin Nr. 26, datë 23.01.2017, “Për ngritjen e strukturës përgjegjëse për sinjalizimin, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe parandalimin e konfliktit të interesave”.

Gjatë periudhës raportuese Janar-Dhjetor 2022, SRR ka kryer konkretisht detyrat e mëposhtme:

- Janë kryer raportimet sipas manualeve dhe kërkesave të tjera të Institucionit;
- Është përditësuar regjistri i riskut;
- Janë kryer dhe detyra të tjera në zbatim të urdhërave të ndryshëm të Titullarit të AZHBR-së.
- Hartimi i objektivave strategjike dhe operacionale në çdo njësi funksionale të AZHBR-së në funksion të menaxhimit të riskut;
- Ka sigurur identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në nivel tërësor dhe në nivel aktiviteti për çdo njësi të AZHBR-së, të cilat çojnë në dështimin apo mosrealizimin e objektivave;

VIII. DREJTORIA E FINANCËS (DF)

1. Sektori i Financës

Në mbështetje të ligjit nr.115/2021, “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2022”, dhe në vijim të Udhëzimit Plotesues të Ministrit të Financave nr.12, datë 29.04.2021 për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, raportojmë mbi performancën e produkteve të buxhetit për Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, sipas programit buxhetor të miratuar për vitin 2022 për periudhën Janar – Dhjetor 2022.

1.1 Aktivitetet e Sektorit të Financës

- Në bashkëpunim me drejtoritë e tjera është bërë ndjekja e buxhetit sipas zërave të shpenzimeve;
- Janë regjistruar në Sistemin Financiar të Qeverisë të gjitha angazhimet dhe shpenzimet e kryera nga AZHBR në llogaritë 600, 601, 602 e 231.
- Janë përlllogaritur dhe kaluar për pagesë, çdo muaj pagat e punonjësve, sigurimet shoqërore & shëndetësore, tatimi mbi pagë, duke zbatuar në çdo rast aktet ligjore e nën ligjore në fuqi, organikën e miratuar, si dhe duke ruajtur planin e buxhetit, të çelur në fillim të vitit;
- Në fund të çdo muaji është bërë rakordimi me Degën e Thesarit, për shpenzimet buxhetore të realizuara, si dhe dorëzimi i fotokopjeve të urdhër-shpenzimeve, në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e tyre;
- Për shpenzimet operative (llog.602), është ndjekur plani i detajuar në fillim të vitit, sipas zërave të shpenzimeve buxhetore.
- Ka kryer hyrjet dhe daljet e artikujve në magazinë, sipas kërkesave të drejtorive të institucionit;

Shpenzimet e fondeve buxhetore për artikujt 600, 601, 602, 231, krahasuar me planin vjetor, janë realizuar konkretisht janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr 20: Shpenzimet e fondeve buxhetore

Llogaria			
Ekonom.	ZERAT KRYESORE TE SHPENZIMEVE	Plani	Fakti
	Paga, shpërblime dhe tjera shpenzime personeli	165,710,917	163,927,019
6001001	Paga, raporte mjeksore dhe shtesa mbi paga	165,710,917	163,927,019
6003900	Shpërblime për personelin (Fondi i veçantë)		
	Kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore	27,919,919	27,345,683
6010100	Kontribute sig. shoqërore	24,745,291	24,794,343
6011100	Kontribute sig. shëndetësore	3,174,628	2,551,340
	Shpenzime Operative (Mallra dhe shërbime gjithësej)	87,285,164	86,758,344

1.2 Shpenzime Personeli (600+601)

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2022 është 158,700,000 lekë me rialokime gjatë muajve fondi i pagave është pakësuar në vlerën 124,817,000 lekë, fondi i realizuar është 84,87,282 lekë ose 8%. Me Urdhërin e Kryeministrit nr.81, datë 10.05.2022, numri i punonjësve të AZHBR është 239. Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 20 datë 19.01.2022 organika e AZHBR është shtuar me 20 punonjës mbështetës. Me Aktin Normativ nr. 12 date 29.07.2022, fondi i pagave është shtuar me shumën 48,600,000. Me shkresën e MBZHR nr.4550/7 datë 08.11.2022 fondi i pagave është pakësuar me 1,500,000 lekë, si rrjedhojë fondi në total është në shumën 171,917,000 lekë. Realizimi 12 mujor për fondin e pagave është 170,778,002 lekë ose 99%. Fondi i sigurimeve me aktin normativ është rritur në shumën 28,756,919 lekë. Shkresa e dërguar nga MBZHR ka pakësuar dhe fondin e sigurimeve me 837,000 lekë, duke e çuar fondin në total 27,919,919 lekë. Realizimi 12 mujor është në shumën e 27,345,683 lekë ose 98%.

1.3 Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera (602)

Fondi i akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2022 për shpenzimet korrente është 94,000,000 lekë, për përmbushjen e nevojave dhe objektivave të AZHBR. Me rialokimet gjatë muajve fondi i shpenzimeve operative u rrit në vlerën 126,000,000 lekë. Me shkresën nr.4550/7 date 08.11.2022 fondi i shpenzimeve operative u shtua në vlerën 3,000,000 lekë. Aktualisht fondi i realizuar i shpenzimeve operative është 128,694,858 lekë ose 99%. AZHBR ka perfunduar procesin e likuidimit të kontrave dhe faturave të vitit 2022.

1.4 Investime (231)

Në zërin investime fondi i akorduar në fillim të vitit ka qenë 2,395,670,461 lekë, ndarë sipas projekteve të investimeve paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr 21: Fondi i alokuar sipas projekteve

Logaria Ekonom.	ZERAT KRYESORE TE SHPENZIMEVE	Plani	Fakti
2310000	Blerje paisje kompjuterike AZHBR	6,300,000	5,816,400
2310000	Pajisje per Agropikat (kamera)	1,200,000	1,157,160
2310000	Sisteme online per skemat IPARD dhe sisteme te reja	123,300,560	123,300,560
2310000	Bashkefinancim per Projekti Help	1,456,120	1,443,040
2310000	Perfitues nga programi IPARD II masa 1	579,627,781	579,390,339
2310000	Perfitues nga programi IPARD II masa 1	1,683,783,000	1,740,975,476
TOTALI		2,395,670,461	2,452,082,972

2. Sektori i Kontabilitetit:

1.1 Objektivat

Në vitin e parë të vitit 2022 Sektori i Kontabilitetit ka kryer regjistrimin e transaksioneve financiare të AZHBR, mbi bazën e dokumentave të marra nga Sektori i Financës, Sektori i Ekzekutimit të Pagesave Kombëtare dhe Sekortët e tjerë IPARD.

Kontabilizimet janë kryer mbi bazën e manualeve të miratuara të Sektorit të Kontabilitetit për Programin IPARD dhe mbi bazën e Standarteve Kombëtare të Kontabilitetit për të gjithë aktivitetin e AZHBR.

1.2 Detyrat dhe realizimet e Sektorit të Kontabilitetit.

- Sigurimi i informacionin të saktë nga drejtoritë e AZHBR-së, për efekt raportimi dhe kontabilizimi.
- Ruajtja dhe regjistrimi i dokumentave hyrëse dhe dalëse, mbi bazen e dokumentave origjinale në përputhje me Manualin e Procedurave IPARD II 2014-2020.
- Regjistrimi i aktivitetit financiar të AZHBR-së, mbi bazën e urdhër shpenzimeve (fotokopje).
- Regjistrimi i të gjitha fletë hyrjeve dhe fletë daljeve (fotokopje) të magazinës.
- Kontabilizimi i fondeve buxhetore, donacionet ndërkombëtare sipas marrëveshjeve përkatëse, si dhe IPARD II 2014-2020.
- Kryerja e të gjithë detyrave në përputhje me manualin, kodin e etikës dhe realizimin e tyre në kohë dhe me përgjegjësinë e duhur.
- Rakordimi mujor me Drejtoritë e tjera të AZHBR-së si dhe me Fondin Kombëtar.
- Përgatitja e pasqyrave financiare dhe rakordimi i llogarive të bilanceve (nacional dhe te programit IPARD II 2014-2020) për mbylljen e veprimeve brënda afateve të përcaktuara.
- Përgatitja e pasqyrave përkatëse në përputhje me Manualin e Procedurave IPARD II 2014-2020.

Detyrat kryesore funksionale të punonjësve të këtij sektori janë regjistrimi i saktë dhe në përputhje me manualin e sektorit të kontabilitetit të të gjithë aktivitetit financiar të AZHBR-së.

Janë bërë regjistrimet e **120 kontratave për vitin 2022** në programin “Alpha IPARD”, brenda afateve dhe duke zbatuar manualet e sektorit të kontabilitetit.

IX. DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Drejtoria Juridike dhe e Shërbimeve Mbështetëse është përgjegjëse për mbështetjen, funksionimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së brendshme të AZHBR-së, në përputhje me kuadrin ligjor në Republikën e Shqipërisë si dhe me legjislacionin e Bashkimit European në lidhje me IPARD.

1. SEKTORI JURIDIK

Për periudhën Janar - Dhjetor 2022 Sektori Juridik ka kryer detyrat si më poshtë:

- Ndjekjen e proceseve gjyqësore me objekt “Zgjidhje Kontratë Kredie”, “Përmbushja e detyrimeve kontraktuale”, “Kundërshtim veprimesh përmbartimore” dhe “Pagimin e padetyruar të shumës”;
- I është kthyer përgjigje brenda afatit të gjitha kërkesave dhe ankesave në Platformen e bashkëqeverisjes si dhe është ngritur rrjeti i raportuesve tek koordinatori i biznesit.
- Hartimin e kthim përgjigjeve, apo akteve të tjera administrative në funksion të zbatimit të detyrimit të Institucionit;

2. BURIMET NJERËZORE

Objektivat e Programit të Njesisë Organizative për periudhën (01.01.2022-31.12.2022) janë:

- Të këshillojë stafin AZHBR në lidhje me politikat e zhvillimit të Burimeve Njerëzore, për mbështetjen operacionale dhe të nevojave të personelit për zhvillimin e procedurave ligjore të miratuara për menaxhimin efikas të burimeve njerëzore të Agjencisë si dhe dhënien e këshillave lidhur me asistencën ligjore për përgatitjen e kuadrit ligjor për të gjitha fushat që mbulon Agjencia, me qëllim që misioni i drejtorisë të realizohet.
- Të hartojë planin e veprimit për përafrimin e strukturës organizative dhe kapaciteteve të saj menaxhuese dhe teknike, me standartet e akreditimit të BE-së.
- Të sigurojë hartimin dhe zbatimin e planit vjetor të nevojave për personel të të gjithë Agjencisë me qëllim plotësimin e vendeve vakant nëpërmjet rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.
- Të sigurojë që stafi kryen detyra në përputhje me manualin, kodin e etikës dhe realizimin e tyre në kohë dhe me përgjegjësinë e duhur.
- Të sigurojë një menaxhim efikas të burimet njerëzore duke përfshirë procedurat e rekrutimit, konsultimit, disiplinës në punë, trajnimin dhe zhvillimin e performancës si dhe motivimin e stafit.
- Të sigurojë përgatitjen e projekteve, planeve dhe iniciativave për gjithë drejtorinë si dhe të sigurojë zhvillimin e programeve të kërkuara në tërësi me qëllim që ato të jenë gjithëpërfshirëse dhe të zbatueshme në të gjithë punën e drejtorisë.

- Të motivojë dhe vlerësojë stafin duke pasur parasysh performancën e tyre, duke përgatitur vlerësime me shkrim për performancën e tyre dhe duke diskutuar këtë proces me ta, nxjerr në pah nevojat e tyre për përmirësim si dhe duke ndihmuar dhe disiplinuar ata sa mund tju kërkohet.
- Të implementojë reformat e administratës publike duke siguruar që ministria zbaton praktikat dhe procedurat e miratuara për menaxhimin e burimeve njerëzore.
- Të analizojë dhe ndjek legjislacionin në fushën e administratës publike, sistemin e sigurimeve shoqërore dhe kujdeset për aplikimet e mundshme të tyre, ndjek legjislacionin e B.E.
- Të sigurojë dhe të mundësojë motivimin e punonjësve dhe promovimin e tyre.
- Të kontrollojë në mënyre sistematike prezencën e punonjësve në punë gjatë orarit zyrtar.
- Të ndjekë lejet e zakonshme për personelin.
- Të përditësojë dokumentat e personelit.
- Të përgatit urdhrat/njoftimet/shkresat sipas kërkesave që dalin për marrëdhëniet e punës.

B. BURIME NJERËZORE

- Nëpunës të liruar për shkak të **(dorëheqjes)** janë **9**:
 - 1 Inspektor i Sektorit të Autorizimit të Pagesave IPARD;
 - 1 Inspektor i Sektorit të Ekzekutimit të Pagesave IPARD;
 - 1 Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit;
 - 1 Drejtor i Drejtorisë së Ekzekutimit të Pagesave;
 - 1 Përgjegjës Menaxhimi i Borxhit;
 - 1 Inspektor i Sektorit të Kontrollit IPARD;
 - 1 Specialist i Sektorit të Burimeve Njerëzore;
 - 1 Specialist Promocioni dhe Komunikimit i Sektorit të Burimeve Njerëzore ;
 - 1 Inspektor i Sektorit të Masës 5, Asistencës Teknike dhe Infrastrukturës Rurale.
- Nëpunës të liruar për shkak të ligjit **(Pezullim)**, janë **2**:
 - 1 Përgjegjës i Sektori i Autorizimit të Pagesave;
 - 1 Specialist i Sektorit të Burimeve Njerëzore.
- Nëpunës të liruar për shkak të ligjit **(Transferim i Përkohshëm)** është **3**:
 - 1 Inspektor DPAP IPARD, Masa 1 dhe Masa 11;
 - 2 Inspektor DPAP IPARD, Masa 3, 4 dhe Masa 7.
- Nëpunës të larguar për shkak të përfundimit të marrëdhënies në, **(Dalje në pension pleqërie)** është **1**:
 - 1 Inspektor DK Skema Kombëtare.
- **Punonjës me kontratë pune në strukturë, të larguar janë 5**:
 - 1 Specialist Info Aplikimi Agropika Tiranë;
 - 1 Specialist Info Aplikimi Agropika Fier;
 - 1 Specialist Info Aplikimi Agropika Librazhd;
 - 1 Specialist Info Aplikimi Agropika Durrës;
 - 1 Nëpunës Informacioni.

II. Nëpunës të emëruar sipas strukturës me transferim të përhershëm, të përkohshëm dhe me kontrata të përkohshme: 106

- Nëpunës të emëruar **përkatesisht sipas strukturës janë 26:**
- Nëpunës të emëruar me **transferim të përhershëm për shkak të ristrukturimit janë 65:**
- Nëpunës të emëruar me **transferim të përkohshëm janë 3:**
- Punonjës të emëruar me **kontratë të përkohshme 22:**

Drejtoria e Perzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve (DPAP)

- *Nëpunës të emëruar sipas strukturës*
 - 1 Përgjegjës DPAP IPARD, masa 3,4,7;
 - 2 Inspektor DPAP IPARD, masa 1 dhe 11;
 - 2 Inspektor DPAP Kombëtare.
 - 1 Inspektor i Sektorit të Masës 5, Asistencës Teknike dhe Infrastrukturës Rurale;
- *Nëpunës të emëruar me transferim të përhershëm për shkak të ristrukturimit*
 - 1 Përgjegjës DPAP IPARD për Masën 1 dhe Masën 11;
 - 11 Inspektor DPAP IPARD për Masën 1 dhe Masën 11;
 - 1 Përgjegjës DPAP IPARD për Masën 3, Masën 4 dhe Masën 7;
 - 11 Inspektor DPAP IPARD për Masën 3, Masën 4 dhe Masën 7;
 - 8 Inspektor DAP IPARD për Masën 1, Masën 3, Masën 7 dhe Masën 9;
 - 6 Inspektor DAP IPARD për Masën 4, Masën 5, Masën 6, Masën 10 dhe Masën 11;
 - 1 Përgjegjës i Sektorit të Masës 5, Asistencës Teknike dhe Infrastrukturës Rurale;
 - 2 Inspektor i Sektorit të Masës 5, Asistencës Teknike dhe Infrastrukturës Rurale;
- *Nëpunës të emëruar me kontratë të përkohshme*
 - 4 Specialist DPAP IPARD Masa 1 dhe Masa 11,
 - 4 Specialist DPAP IPARD Masa 3, Masa 4 dhe 7,

Drejtoria e Autorizimit të Projekteve (DAP)

- *Nëpunës të emëruar sipas strukturës*
 - 1 Drejtor i Drejtorisë së Autorizimit të Pagesave;
 - 1 Inspektor i Sektorit të Autorizimit të Pagesave Kombëtare;
 - 1 Përgjegjës i Sektorit të Autorizimit të Pagesave IPARD, masa 4, 5, 6, 10 dhe 11;
 - 1 Përgjegjës i Sektorit të Autorizimit të Pagesave IPARD, masa 1,3,7,9;
 - 2 Inspektor i Sektorit të Autorizimit të Pagesave IPARD, masa 1,3,7,9;
 - 2 Inspektor i Sektorit të Autorizimit të Pagesave IPARD, masa 4, 5, 6, 10 dhe 11.
- *Nëpunës të emëruar me kontratë të përkohshme*
 - 3 Specialist DAP IPARD,

Drejtoria Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse (DJSHM)

- *Nëpunës të emëruar sipas strukturës*
 - 1 Përgjegjës i Sektorit të Burimeve Njerëzore;
 - 1 Specialist i Sektorit të Burimeve Njerëzore;
 - 1 Përgjegjës i Menaxhimit të Borxhit;

- *Nëpunës të emëruar me transferim të përhershëm për shkak të ristrukturimit*
 - 1 Përgjegjës i Sektorit të Protokollit dhe Arkivës;
 - 1 Specialist Arkive i Sektorit të Protokollit dhe Arkivës;
 - 2 Specialist i Sektorit të Burimeve Njerëzore;
 - 1 Specialist Promocioni dhe Komunikimi i Sektorit të Burimeve Njerëzore;
 - 1 Specialist i Sektorit Juridik;

- *Nëpunës të emëruar me kontratë të përkohshme*
 - 2 Specialist Burimesh Njerëzore,
 - 1 Specialist në Sektorin e Menaxhimit të Borxhit,
 - 1 Punonjës Arkive,
 - 1 Operator.

Drejtoria e kontrollit (DK)

- *Nëpunës të emëruar sipas strukturës*
 - 1 Përgjegjës i Sektorit të Kontrollit IPARD;
 - 1 Drejtor i Drejtorisë së Kontrollit;

- *Nëpunës të emëruar me transferim të përkohshëm*
 - 1 Përgjegjës Sektori i Kontrollit IPARD;

- *Nëpunës të emëruar me kontratë të përkohshme*
 - 4 Specialist në Sektorin e Kontrollit IPARD,

Drejtoria e Monitorimit të Skemave, Riskut dhe Raportimit; (DMSRR)

- *Nëpunës të emëruar sipas strukturës*
 - 1 Drejtor i Drejtorisë së Monitorimit të Skemave, Riskut dhe Raportimit;
 - 1 Përgjegjës i Sektorit të Riskut dhe Raportimit;
 - 1 Inspektor i Sektorit të Monitorimit të Investimeve IPARD;

- *Nëpunës të emëruar me transferim të përhershëm për shkak të ristrukturimit*
 - 1 Përgjegjës i Sektorit të Monitorimit të Investimeve Kombëtare;
 - 3 Inspektor i Sektorit të Monitorimit të Investimeve IPARD;
 - 1 Inspektor i Sektorit të Monitorimit të Investimeve Kombëtare;
 - 2 Inspektor i Sektorit të Riskut dhe Raportimit;

- *Nëpunës të emëruar me transferim të përkohshme*
- 1 Inspektor Sektori i Monitorimit të Investimeve Kombëtare.

Drejtoria e Financës (DF)

- *Nëpunës të emëruar sipas strukturës*
- 1 Drejtor i Drejtorisë së Financës;

Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit (DTI)

- *Nëpunës të emëruar sipas strukturës*
- 1 Drejtor i Drejtorisë së Teknologjisë dhe Informacionit.
- *Nëpunës të emëruar me transferim të përhershëm për shkak të ristrukturimit*
- 4 Specialist në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit.
- *Nëpunës të emëruar me kontratë të përkohshme*
- 2 Specialist në Drejtorinë e Teknologjisë së Informacionit.

Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave (DEP)

- *Nëpunës të emëruar sipas strukturës*
- 1 Inspektor i Ekzekutimit të Pagesave IPARD.
- *Nëpunës të emëruar me transferim të përkohshëm*
- 1 Inspektor Sektori i Ekzekutimit IPARD.

Drejtoria e Bazës së të Dhënave dhe Studimit të Tregut (DBDHST)

- *Nëpunës të emëruar sipas strukturës*
- 1 Inspektor i Sektorit të Studimit të Tregut.
- *Nëpunës të emëruar me transferim të përhershëm për shkak të ristrukturimit*
- 1 Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit dhe Statistikave;
- 4 Inspektor i Sektorit të Regjistrimit dhe Statistikave;
- 1 Inspektor i Sektorit të Studimit të Tregut;

Sektori i Parrregullive dhe Parandalimit të Mashtrimit (SPPM)

- *Nëpunës të emëruar me transferim të përhershëm për shkak të ristrukturimit*
- 1 Përgjegjës i Sektorit të Parrregullive dhe Parandalimit të Mashtrimit;

III. Plotësimi i strukturës do të vazhdojë edhe me 52 konkurime te tjera:

Drejtoria e Perzgjedhjes dhe Aprovimit të Projekteve (DPAP)

- 1 Inspektor DPAP IPARD, Masa 3, Masa 4 dhe 7;
- 6 Inspektor DPAP IPARD, Masa 1 dhe Masa 11;
- 3 Inspektor DAP IPARD për Masën 1, 3, 7 dhe 9;
- 2 Inspektor DAP IPARD për Masën 4, 5, 6, 10 dhe 11;
- 2 Inspektor në Sektorit të Masës 5, Asistencës Teknike dhe Infrastrukturës Rurale;

Drejtoria e Autorizimit te projekteve (DAP)

- 1 Inspektor DAP Kombëtare;
- 1 Përgjegjës DAP Kombëtare;
- 2 Inspektor DAP Kombëtare;

Drejtoria e kontrollit (DK)

- 5 Inspektor në Sektorit të Kontrollit IPARD;
- 5 Inspektor në Sektorin e Kontrollit Skema Kombëtare;
- 1 Specialist Info-Aplikim Agropika Durrës;

Drejtoria e Ekzekutimit të Pagesave (DEP)

- 1 Drejtor në Drejtorinë e Ekzekutimit të Pagesave;
- 1 Inspektor në Sektorin e Ekzekutimit të Pagesave IPARD;

Drejtoria Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse (DJSHM)

- 2 Specialist në Sektorin Juridik;
- 1 Përgjegjës i Sektorit Juridik;
- 1 Specialist Protokolli;
- 2 Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore;
- 1 Specialist Promocioni dhe Komunikimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore;

Drejtoria e Teknologjisë dhe Informacionit (DTI)

- 1 Specialist në Dretorine e Teknologjisë së Informacionit;

Sektori I Auditit të Brendshëm

- 2 Specialist në Sektorin e Auditit të Brendshëm,

Sektori i Parregullsive dhe Parandalimit të Mashtrimit (SPPM)

- 2 Specialist në Sektorin e Parregullsive dhe Parandalimit të Mashtrimit;

Drejtoria e Bazës së të Dhënave dhe Studimit të Tregut (DBDHST)

- 1 Drejtor në Drejtorinë e Bazës së të Dhënave dhe Studimit të Tregut;
- 1 Përgjegjës në Sektorin e Studimit të Tregut;
- 1 Përgjegjës në Sektorin e Regjistrave dhe Statistikave;

Drejtoria e Monitorimit të Skemave, Riskut dhe Raportimit; (DMSRR)

- 1 Përgjegjës në Sektorin e Monitorimit të Investimeve IPARD;
- 1 Inspektor në Sektorin e Monitorimit të Investimeve Kombëtare;

Drejtoria e Financës (DF)

- 1 Specialist në Sektorin e Kontabilitetit
- 1 Specialist në Sektorin e Financës;

IV. Gjatë muajve Janar-Dhjetor 2022, janë realizuar përafërsisht **38 tema** trajnimi me stafin e strukturës IPARD dhe atë Kombëtar sipas nevojave specifike. Trajnimet kanë qenë të brendshme dhe online nga stafi më me përvojë në institucion por edhe nga ekspertë të jashtëm.

Tabela nr 22: Temat e trajnimeve

Nr.	Tema
1	"Menaxhimi dhe auditimi I fondeve të BE"
2	Irregularities and Fraud Prevention
3	"Reforma e sektorit energjetik dhe tregu i energjisë"
4	Trajnim mbi kapitullin 11 dhe Politikat e Perbashketa Bujqesore CAP
5	Healthy Leadership, Healthy Employees and Resilient Organisations - Wellbeing at Work
6	Navigating Between Work and Private Life: Effective Boundary Management in the Home
7	Financimi i politikave të BE-së në kuadrin financiar shumëvjeçar 2021-2027
8	Treguesit e performancës, roli dhe rëndësia e tyre gjatë procesit të përgatitjes së PBA
9	Menaxhimi financiar i fondeve të IPA dhe IPARD
10	Analizimi, përpunimi dhe vizualizimi i të dhënave
11	Simulimi i një dosje për kontrollin administrativ deri në kontraktim IPARD
12	Simulimi i një dosje për pagesë IPARD
13	Etika, komunikimi dhe konflikti i interesit në administratën publike
14	Informacioni i përgjithshëm mbi programin IPARD
15	Parregullsitë dhe mashtrimi
16	Trajnim me bazë ligjore dhe tipet e kontratave të grantit në AZHBR
17	Grupat teknik standartet minimale kombëtare për secilin prej tyre
18	"Perpektiva e re financiare e mbështetjes së BE-së nëpërmjet IPA III (pjesa 2)"
19	Mbështetja financiare e BE për shqipërinë me fondet IPARD
20	Rregullat e reja të menaxhimit të fondeve të BE për IPARD III
21	Trajnim në lidhje me rivlerësimin për përdorimin e softit për IPARD II
22	TAIEX misionon për përgatitjen për akreditimin, Paketë për IPARD Mësurë 4
23	Siguria Kibernetike

24	Gjetjet e Auditit
25	Meeting with Mr. Alexander Hinov
26	New procedure for regularity on and checklist templates PRAG Rules
27	Clear Desk and Clear Screen Policy
28	Development and update of methodologies for impact assessment for investments under IPARD including training of relevant staff from the pa and ma in performance of such impact assessments
29	Meeting with technical bodies(food, veterinary and environmental protection agency)
30	On the job support on irregularities
31	Preparation of Ebit for measure 11 "Establishment and Protection of forest" TAIEX
32	Strengthening the capacities and the effectiveness of the IPARD structures and audit authority in regard to IPARD programme implementation(closure seminar)
33	Training on IPARD III procedure for Entrustment Budget Implementation Taska
34	Training on measure 6- preparation of procedures and documents for accreditation
35	Training on the application of the sound financial management by the IPARD agency
36	Trajnim lidhur me masën 6 "Investime në infrastrukturën rurale dhe publike"
37	Trajnim mbi procedurat e DAP, IPARD
38	Simulimi I një dosje për kontrollin në terren, IPARD

3. SEKTORI I MENAXHIMIT TE BORXHIT

- Në bashkëpunim me sektorin juridik rast pas rasti është bërë dhe rishikuar llogaritja e penalteteve sipas kërkesave të bëra nga Gjykata.
- Cdo muaj në mënyrë të herë pashërshme janë marrë lëvizjet bankare dhe janë hedhur arkëtimet në excel.
- Është kontrolluar lista e debitorëve në të gjitha rastet si për skemat kombëtare, kërkesa të tjera nga Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave.
- Janë kthyer përgjigje shkresave të ndryshme të adresuara ndaj SMB.
- Janë kryer dhe detyra të tjera në zbatim të urdhërave të ndryshëm të Titullarit të AZHBR-së.
- Realizimi i detyrave të tjera të ngarkuara nga drejtori i DJSHM

X. DREJTORIA E TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT

1. Detyrat dhe kompetencat

Sipas Rregullores së Brendshme të AZHBR dhe Manualeve të Procedurave Të Drejtorisë së IT detyrat specifike dhe kompetencat e stafit të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit gjatë periudhës raportuese 01 Janar 2022 – 31 Dhjetor 2022 kanë qënë si më poshtë vijon:

1. Zbatojnë detyrat e përcaktuara në Urdhra të Posaçëm nga Drejtori i Përgjithshëm i AZHBR;
2. Menaxhojnë, dhe sigurojnë funksionimin e Sistemeve të Menaxhimit të Informacionit.
3. Menaxhojnë përdoruesit në sistemet MIS dhe formularët përkatës në përputhje me procedurat e DIT;
5. Ndihmojnë përdoruesit për përdorimin e sistemeve dhe funksioneve të teknologjisë së informacionit në mënyrë të drejtpërdrejtë, ose përmes zgjidhjes së problematikave;
6. Sigurojnë edukimin e përdoruesve mbi funksionet e sistemeve dhe se si të përdorin me efektivitet pajisjet dhe programet për kryerjen e detyrave të ngarkuara;
7. Sigurojnë monitorimin, riparimin, modifikimin apo përmirësimin e pajisjeve apo programeve ekzistuese, duke përfshirë këtu mirëmbajtjen dhe kujdesin periodik për pajisjet dhe të dhënat;
8. Sigurojnë që çdo nëpunës është në domain e AZHBR dhe është pajisur me një email zyrtar;
9. Ofrojnë suport për rrjetin kompjuterik dhe pajisjet në rastet kur ka nevojë në institucion;
10. Përgatisin raportet 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore në lidhje me punën e kryer, problematikat/defektet e hasura në punën e përditshme të gjithë Agjencisë;
12. Suport teknik për Sistemin e PRDB;
13. Sigurojnë monitorimin dhe funksionimin e infrastrukturës së sistemeve dhe paisjeve të tjera të vendosura në dhomën e serverit në AZHBR si dhe në Datacenter Qeveritar;
15. Monitorojnë dhe menaxhojnë të dhënat në Active Directory për llogaritë e përdoruesve, të cilat përfaqësojnë identitetin e njerëzve që përdorin rrjetin, grupet e sigurisë, kompjuterat, IP-të dinamike dhe të rezervuara.

2. Objektivat dhe detyrat kryesore të DTI për periudhën Janar – Dhjetor 2022

Gjatë vitit 2022, aktivitetet kryesore të DTI janë përqëndruar në realizimin e objektivave të mëposhtme:

- Sigurimi që çdo kompjuter është pjesë e domain gov.local;
- Siguria që çdo punonjës është pajisur me user/password personal;
- Hapja/çaktivizimi i userave për punonjësit e rinj dhe ato të larguar;
- Menaxhimi i helpdeskut nëpërmjet adresës së e-mail helpdesk.it@azhbr.gov.al;
- Përgatitja e raporteve javore të helpdeskut;
- Përgatisin raportet 3-mujore, 6-mujore, 9-mujore dhe vjetore në lidhje me punën e kryer, problematikat/defektet e hasura në punën e përditshme të gjithë Agjencisë;
- Përgatitja e Regjistrimit të Riskut për Drejtorinë e IT;

- Komunikim i vazhdueshëm me AKSHI për problematika të ndryshme të hasura gjatë procesit të punës;
- Update i programeve të instaluar në kompjutera;
- Formatimi i kompjuterave aty ku është e nevojshme;
- Planifikimi i punëve që do kryhen në drejtori duke ndjekur me rigozitet procedurat e DTI;
- Plotësimi i formularëve standart, pjesë e Manualit të procedurave DTI;
- Mirëmbajtja e softve për Skemat e financimit: MIS Skema Kombetare, MIS IPARD II;
- Monitorimi i fazave të realizimit për Përmirësimin e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për
- Trajnimi i stafit të ri për përdorimin e pajisjeve elektronike (skanime);
- Trajnimi i stafit të ri mbi Manualet e Procedurave të DTI;
- Kryerja e Back-up për Sistemin e Menaxhimit të Softit IPARD II dhe Skemave Kombëtare për vitin 2022;
- Përditësim i inventarit elektronik të pajisjeve elektronike;
- Identifikimi i aseteve Hardware dhe Software të AZHBR;
- Suport teknik për Agropikat dhe inspektorët nëpër rrethe;
- Marrja pjesë në grupe të ndryshme pune sipas urdhërit të Titullarit;
- Komunikim dhe ndjekje me AKSHI-in për kontratën për shërbimin e internetit për Agropikat dhe AZHBR;
- Ndjekje e punës sipas urdhërit për “Komisioni i vlerësimit për nxjerrje jashtë përdorimi”;
- Ndjekje e punës sipas urdhërit për “Komisioni për aktivet e propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi”;
- Ndjekje e punës sipas urdhërit për “Komisioni i inventarizimit të aseteve të AZHBR, për vitin 2022”;
- Parashikimet buxhetore për nevojat e Sektorit të IT për periudhën 2023-2025.
- Suport i vazhdueshëm për Skemën Mbështetëse të Naftës;
- Suport i vazhdueshëm për userat në Modulin e Kadastrës ASHK;
- Takime në MBZHR, për Regjistrin e Fermës;
- Takime për Portalin e fermerit për ndërfaqen e regjistrimit të çmimeve ditore të tregjeve të shumicës;
- Dorëzimi i sistemit PRDB dhe marrëveshje me AKSHI për mirëmbajtjen e PRDB si pjesë IPARD III;
- Ngritja e grupit të punës për ndjekjen e kontratës për objektin “Përmirësim i Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Programin IPARD”;
- Hartimi i Marrëveshjes së Mospërhapjes së informacionit midis AZHBR-AKSHI-ABS;
- Ngritja e grupit të punës për PRDB, suport për ndryshime në sistemin PRDB.
- Monitorimi i platformës online SQDNE, trajnimi mbi përdorimin dhe aplikimin për nëshkrim online.
- Rishikimi dhe përmirësimi i Manualeve të Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.
- Rishikuar dhe përditësuar procedura “Contingency Plan for ARDA”, në pritje për tu miratuar nga NAO;
- Draftim i procedurës së re E-9.0-1.0 Information Security Policy, në pritje për tu miratuar nga NAO;
- Draftimi i Rregullores për Sigurinë e Informacionit midis AZHBR dhe AKSHI;
- Suport i vazhdueshëm për skemën kombëtare të grurit, për vitin 2022.

3. Arritje

- Bazuar në rekomandimet e DG-Agrit është bërë identifikimi dhe vlerësimi i situatës aktuale për zgjidhjen dhe realizimin e rekomandimeve të lëna. Është marrë miratimi i Drejtores së Përgjithshme për të realizuar gjithë kërkesat, bazuar në buxhetin për vitin 2022;
- Asistencë e vazhdueshme për punonjësit e AZHBR gjatë procesit të skanimit të dosjeve për Thirrjen e 4, për Programin IPARD II;
- Bllokimi i media storage për punonjësit e AZHBR;
- Asistencë e vazhdueshme për punonjësit e Agropikave, AREB dhe punonjësve të DPAP gjatë periudhës së aplikimit dhe në vijim, për Skemat Kombëtare dhe Skemën e Naftës për vitin 2022 dhe Skemën e Grurit;
- Shpërndarja dhe konfigurimi i pajisjeve MFD dhe pajisja me PC sipas nevojave nëpër Agropika për procesin e aplikimeve për Skemat Kombëtare dhe Skemë e Naftës për vitin 2022 dhe Skemën e Grurit;
- Inventari i gjithë rrjetit kompjuterik të AZHBR;
- Suport teknik për mirëmbajtjen e pajisjeve elektronike: kompjutera, fotokopje, printera, ups, telefon voip etj;
- Suport për pajisje për trajnim ose arsye të tjera në funksion të punës, plotësimi i formulareve përkatës;
- Përgatitja dhe finalizimi i ToR për Skemat Kombëtare Online;
- Bërja e back-up për Sistemin e Menaxhimit të Skemave Kombëtare 2022 dhe Programin IPARD II;
- Dokumentimi i të gjithë proceseve sipas formulareve të manualeve të procedurave të DTI;
- Përgatitja e template për trajnime për Stafin e AZHBR, për “Clear Desk and Clear Screen Policy”;
- Finalizimi i MoP të DIT, për paketën e Akreditimit për Programin IPARD III, së bashku me table of changes;
- Rikthimi i PC në gjëndje pune duke instaluar të gjithë programet mbrojtëse (MDE, Antivirus, Microsoft Safety Tool Scan dhe agjentin SCCM) dhe rikthimin në funksionalitet i të gjithë shërbimeve për Agjencisë;
- Formatim i PC dhe futja në domain së bashku me gjithë paketën e programeve mbrojtëse;
- Investime në Back-up Server Room për përmirësimin e kushteve;
- Rregjistrimi i logeve për akses kontrollin e dhomës së serverëve;
- Ngritja e grupit të punës për Business Continuity Plan;
- Urdhëri i Koordinatorit të Riskut për DTI;
- Realizimi i inventarit të aseteve të AZHBR, për vitin 2022;
- Adresimin e gjetjeve nga realizimi i PenTest dhe Vulnerability Scanning tek kompanitë e mirëmbajtjes dhe ndjekjen e realizimit të tyre;
- Realizimi i Projektit “Portali i Fermerit”;
- Realizimi me sukses i të gjitha kontratave të ndjekura nga grupet e punës me përfaqësues nga DIT.

XI. DREJTORIA E BAZËS SË TË DHËNAVE DHE STUDIMIT TË TREGUT

Drejtorja e Bazës së të Dhënave dhe Studimit të Tregut garanton zbatimin e politikave integruese evropiane me programe të zhvillimit bujqësor dhe rural, me qëllim realizimin e objektivave strategjike për arritjen e standardeve kombëtare në mbështetje të financimit të përfituesve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për bujqësinë dhe zhvillimin rural, përmes administrimit të fondeve të buxhetit të shtetit dhe të donatorëve të huaj.

Kjo drejtori përbëhet nga 1një drejtor dhe 2 dy sektorë, Sektori i Regjistrave dhe Statistikave, Sektorit të Studimit të Tregut.

Gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2022, DBDHST ka kryer konkretisht detyrat e mëposhtme:

1. Sektori i Regjistrave dhe Statistikave

- a) Ka regjistruar dhe kryer ruajtjen dhe përditësimin në sistemin e RPDB të informacionit financiar të marrë nga subjektet;
- b) Kryen procesin e regjistrimit dhe përditësimit të informacioneve administrative të subjekteve;
- c) Kryen procesin e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të RPDB;
- d) Kontribuon në përgatitjen e ndryshimeve në Manualin e Procedurave të drejtorisë dhe anekseve;
- e) Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga titullari i institucionit.
- f) Kontrollon zbatimin e procedurës për kërkimin e tregut;
- g) Kontrollon përgatitjen e "Specifikimeve Teknike";
- h) Kontrollon vlerësimin e besueshmërisë së dhe informacionit financiar të dërguar nga subjektet;
- i) Kontrollon zbatimin e ligjit për trajtimin e informacionit financiar si Sekret Tregtar;

2. Sektorit të Studimit të Tregut.

- j) Ka kryer procedurën e identifikimit të subjekteve potenciale që mund të ofrojnë informacion financiar (oferta) sipas llojit të investimeve të parashikuara në programin IPARD;
- k) Ka kryer procedurat e kërkimit të tregut;
- l) Kontrollon dhe informacionin financiar të marrë nga subjektet duke e konsideruar si "Sekret Tregtar";
- m) Ka përgatitur "Specifikimet teknike" sipas llojit të investimit;
- n) Kryen procesin e vlerësimit të besueshmërisë së të informacionit financiar të dërguar nga subjektet;
- o) Kontribut në përgatitjen e ndryshimeve të në Manualin e Procedurave të drejtorisë dhe anekseve;
- p) Kryen detyra të tjera të ngarkuara nga titullari i institucionit.
- a) Kontrollon zbatimin e procedurës për regjistrimin, ruajtjen dhe përditësimin në sistemin e RPDB të informacionit financiar (të marrë nga subjektet);
- b) Kontrollon procesin e regjistrimit të përditësimit të informacioneve administrative të subjekteve;
- c) Kontrollon procesin e menaxhimit dhe mirëmbajtjes së sistemit të RPDB;
- d) Kontrollon zbatimin e ligjit për trajtimin e informacionit financiar si Sekret Tregtar;

XII. SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Sektori i Auditit të Brendshëm, në AZHBR ka kryer veprimtarinë e tij në përputhje me Ligjin Nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, Urdhër Nr. 100, datë 25.10.2016, “Për miratimin e manualit të auditimit të brendshëm”, të Ministrit të Financave dhe VKM Nr. 806, datë 06.12.2006 “Metodika e auditimit financiar”, Standardet e Auditimit të Brendshëm dhe Kodin e Etikës për Audituesit.

- Në përputhje me Planin Vjetor të Auditimit të miratuar për vitin 2022, janë parashikuar gjithësej **9 misione auditimi** nga të cilat nga të cilat 2 (dy) auditime financiare; 4 (katër) të përputhshmërisë; 2 (dy) të kombinuar, 1 i teknologjisë së informacionit. Sistemi i proceseve organizative për menaxhimin e fondeve të BE

Gjatë vitit 2022 janë realizuar 8 misione auditimi në përputhje me Planin Vjetor 2021 me ndryshimet e miratuara nga titullari :

- ❖ Auditim Sistemi i Zbatimit të Rekomandimeve në AZHBR në zbatim të Urdhërit Nr.10 Prot. datë 12.01.2022, të Drejtores së Përgjithshme të AZHBR-së, auditim përputhshmërie;
- ❖ Auditim Sistemi i përgatitjes së infrastrukturës së Agropikave, funksionalitetin dhe ofrimin e shërbimeve për fermerët në zbatim të Urdhërit Nr.42, datë 04.02.2022 të Drejtores së Përgjithshme të AZHBR-së për periudhën 2020, 2021, auditim me bazë sistemi i kombinuar.
- ❖ Auditim i Sistemit të “Funksionimit të Drejtorisë Juridike dhe Shërbimeve Mbështetëse, AZHBR” në zbatim të Urdhërit nr.112, datë 28.03.2022 të Drejtores së Përgjithshme të AZHBR-së për periudhën 01.01.2020 – 31.12.2021, auditim përputhshmërie.
- ❖ Auditimi i Sistemit të Pagesave për subvencionet në bujqësi-Skemat Kombëtare në zbatim të Urdhërit nr.293, datë 01.07.2022 të Drejtores së Përgjithshme të AZHBR-së për periudhën 01.01.2020-27.05.2022, Auditim financiar.
- ❖ Auditimi i Sistemit të proceseve organizative dhe operacionale për menaxhimin e fondeve të BE (IPARD II), Thirrja publike I, II, III, IV, në AZHBR, në zbatim të Urdhërit nr.235, datë 27.05.2022 të Drejtores së Përgjithshme të AZHBR-së për periudhën 01.01.2020-27.05.2022, auditim me bazë sistemi i kombinuar.
- ❖ Auditim “Sistemi i teknologjisë së Informacionit, follow Up rekomandimet e lëna në angazhimin e auditimit “Enquiry No ITR/2021/001/AL concerning IPARD II program - Audit mission by the Directorate General for Agriculture and Rural Development (DG AGRI) to Republic of Albania”. Në kuadër të detyrimeve ligjore dhe në zbatim të Ligjit Nr. 37/2015, “Për ratifikimin e Marrëveshjes Kuadër ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për rregullat e zbatimit të mbështetjes financiare të BE-së për Shqipërinë”, Marrëveshjes Sektoriale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian gjatë vitit 2022 Sektori i Auditimit të Brendshëm është angazhuar në procedurën e follow up të rekomandimeve të lëna nga DG-AGRI për sistemin e teknologjisë së informacionit, standardet e sigurisë së informacionit: ISO standard 27002:2013.
- ❖ Auditimi i Sistemit të prokurimeve, në zbatim të Urdhërit Nr. 567, datë 31.10.2022 të Drejtores së Përgjithshme të AZHBR-së për periudhën 01.01.2021-31.12.2021, auditim përputhshmërie.

- ❖ Auditimi i “Sistemit të Kontabilitetit dhe Raportimit, paga dhe pagesa”, në zbatim të Urdhërit Nr. 644, datë 01.12.2022 të Drejtores së Përgjithshme të AZHBR-së për periudhën 30.11.2021- 30.12.2022, auditim financiar.
- ❖ Auditimi “**Self-assessment audit IPARD III**” nuk u realizua gjatë vitit 2022 sipas planifikimit, pasi paketa ligjore, përfshirë Marrëveshjen Sektoriale, Marrëveshjen Financiare; të domosdoshme për implementimin e programit IPARD III, nuk u miratuan sipas parashikimeve brenda muajit dhjetor.

XIII. SEKTORI I PARREGULLSIVE DHE PARANDALIMIT TE MASHTRIMIT

Sektori i Parregullsave dhe Parandalimit të Mashtrimit është përgjegjës për bashkërendimin e aktiviteteve lidhur me procesin e menaxhimit të parregullsave në zbatim të Manualit të procedurave të Sektorit por edhe Manualeve për Menaxhimin e Kontrollit të Brendshëm.

Objektivi kryesor është investigimi dhe raportimin e rasteve të parregullsave dhe mashtrimeve të identifikuara gjatë ushtrimit të aktiviteteve dhe funksioneve në AZHBR.

Gjithashtu ky sektor ka për detyrë kryejë të gjitha detyrimet dhe raportimet në cilësinë e Strukturës Përgjegjëse për Sinjalizimin, Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesave” për AZHBR-në, të ngritur me Urdhërin Nr. 26, datë 23.01.2017, “Për ngritjen e strukturës përgjegjëse për sinjalizimin, mbrojtjen e sinjalizuesve dhe parandalimin e konfliktit të interesave”.

Gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2022, SPPM ka kryer konkretisht detyrat e mëposhtme:

- Janë trajtuar të gjitha parregullsitë e raportuara;
- Është përditësuar regjistri i riskut për sektorin;
- Janë shqyrtuar sinjalet e parregullsave;
- Dergimi i regjistrit të parregullsave tek NAO;
- Janë kryer dhe detyra të tjera në zbatim të urdhërave të ndryshëm të Titullarit të AZHBR-së.

XIV. PROBLEMATIKA TË EVIDENTUARA

Gjatë aktiviteteve të AZHBR në periudhën raportuese Janar – Dhjetor 2022 në drejtim të mbështetjes së fermerëve me masat mbështetëse, janë evidentuar problematikat e mëposhtme:

- Vështirësi në rekrutimin e stafit të ri, për shkak të procedurave dhe vonesave në shpalljen e pozicioneve vakante në DAP.
- Mungesë stafi për të suportuar teknikisht dhe me efieience sistemet software dhe hardware
- Mungesë e një server room me standarte
- Koha e gjatë e rimbursimit të llogarive për arsye të shkresave transferuese, që miratohen nga Ministria e Financave;
- Vlera e ulët e arkëtimeve për shkak të moslikuidimit nga debitorët;
- Sektori IPARD në DAP, 60% e stafit të ri (nevojë për forcimin e kapaciteteve me trajnime për njohjen e dokumentacionit bazë të kërkesës për pagesë);
- Fuqizimi i politikës së mbajtjes dhe motivimit të stafit (ristrukturimi ndikon direkt në humbjen e kapaciteteve dhe njohurive);
- Në aspektet operacionale varësi vetëm nga kompania e jashtme në lidhje me sistemin MIS (vonesa në suport);
- Trupat teknikë, nuk njohin dokumentacionin e standartizuar dhe rregullat e IPARD (kontakt të drejtpërdrejtë për çdo aplikant për orientim në lidhje me standartet kombëtare dhe të BE-së)
- Mungesa në materiale pune për çdo inspektor të kontrollit në terren (GPS, metër lazer, mushama, çizme, antidotë ndaj pickimeve).
- Mungesë në numrin e inspektorëve në të dy sektorët për kontrole më efektive në kohë më të shkurtër.
- Logjistika: Pak mjete transporti në dispozicion të shumë grupeve të kontrollit përbën vështirësi për levizjet në terren. Është e nevojshme pajisja me makina në qarqet që kanë shtrirje të gjerë.
- Koha e pamjaftueshme për realizimin e projekteve për aplikantët, për shkak të përfundimit të Programit IPARD II (Dhjetor 2023).
- Vonesat në korrespondencën me aplikantët—shpesh posta e ka të pamundur të lokalizojë aplikantet dhe njoftimet publike janë nxjerre për një numër aplikimesh.
- Koha e pamjaftueshme për një numër aplikantësh për marrjen e lejes së ndërtimit.
- Rritja e çmimeve për mallrat dhe shërbimet në rajon që kanë penguar aplikantët të përfundojnë në kohë zërat e investimit.
- Rakordimi i listë pagesave me bankat e nivelit të dytë për fermerët të cilët kanë probleme, me numrat e llogarive bankare jo aktive duke sjellë vonesa në pagesën e të gjithë listës. Këto problematikat vijnë për shkak të politikave të ndjekura nga vetë banka që mbyllin llogaritë e fermerëve kur nuk kryejnë veprime në atë llogari edhe pse nuk ka kaluar 3 muaj nga hapja e llogarisë. Ndryshimi i sistemeve dhe formatet e exceleve të bankave ka sjellë problematika në kalimin e listë pagesave.

XV. REKOMANDIME

Në lidhje me problematikat e evidentuara, me qëllim përmirësimin e punës dhe rritjen e efikasitetit, propozohen rekomandimet e mëposhtme:

1. Në mënyrë që të mos ketë ngarkesë rrjeti dhe të ketë mirëfunksionim të infrastrukturës TIK, kërkohet rikonfigurim i rrjetit në mënyrë që të shtohen portat e internetit, si dhe rregullimi i portave ekzistuese.
2. Mundësimi i ndërveprimit dhe shkëmbimit të të dhënave me bazat e të dhënave shtetërore nëpërmjet platformës qeveritare të ndërveprimit.
3. Rishikimi i Udhëzimit të Ministrisë dhe Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural në lidhje me autorizimin e pagesave direkte.
4. Planifikimi dhe realizimi i trajnimeve të përgjithshme dhe specifike për të gjithë Stafin e AZHBR.
5. Të gjitha llogaritë bankare të fermerëve që vijnë për ekzekutim nga SEP duhet të bashkëlidhen në sistem nga drejtoritë DPAP, DK dhe DAP sipas manualit të procedurave. Të bëhet një marrëveshje institucionale me bankat e nivelit të dytë për të lehtësuar dhe përcaktuar afatet e kalimit të listë pagesave.
6. Nevojë për trajnime për njohjen e procedurave të masave të reja: Masa 4, 5, 6, 10 dhe 11.
7. Nevojitet rindërtimi i një dhome serveri sipas kriterëve dhe kushteve bashkëkohore dhe rikabllimi i gjithë rrjetit kompjuterik minimumi me kategorinë CAT 6E.